



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:093799
Datë: 25.09.2023
Numri i dokumentit: 04716447

APS.nr.21/2023

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, Departamenti Special – kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Ferit Osmani kryetar i kolegjit, Bashkim Hyseni dhe Afërdita Bytyçi-anëtarë të kolegjit, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Syzana Goxhuli, në çështjen penale kundër të akuzuarve B.A, H.H, A.H, V.SH, S.P, M.K, Xh.B, N.Sh, S.B, I.B, S.H, Sh.L, E.Ç, J.G, B.R, J.L dhe A.H të dyshuar secili veç e veç për veprën penale shpëlarje e parave (vepra penale në bashkim dhe vazhdimësi) në bashkëkryerje në kundërshtim me nenin 23 dhe 71 të KPRK-së, në fuqi deri me datë 31.12.2012, po ashtu e paraparë edhe në nenet 31 dhe 81 të Kodit të ri Penal të Kosovës në fuqi prej 01.01.2013, në kundërshtim me nenin 10 (2) të Rregullores së UNMIK-ut, nr. 2004/2 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe veprave penale të përafërta“, po ashtu në kundërshtim me nenin 32 të ligjit nr. 03/L-196 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit” në fuqi prej 30 shtator 2010, po ashtu e paraparë me nenin 56(1) të ligjit nr. 05/L-096, “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit“ në fuqi prej 15 qershor 2016, siç referohet në nenin 308 të KPRK-së, në fuqi prej 1 Janar 2013, lëshohet me datën 19.06.2023, duke vendosur në lidhje me ankesën e Prokurorisë Special të Republikës së Kosovës si dhe përgjigjen në ankesën e PSRK-së të ushtruar nga mbrojtësit e të akuzuarve B.A, av.Kujtim Kërveshi, V.SH, av. Hekuran Haxhimusa, J.G, av. Ibrahim Dobruna, J.L, av.Mustafë Radoniqi, S.B, av.Alban Makolli, dhe përgjigjen në ankesën e PSRK-së nga vet i akuzuari I.B, të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore-Departamenti Special, PS.nr.27/2019 i datës 23.12.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 05.07.2023, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e Prokurorit të Prokurorisë Speciale të Republikës Kosovës, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti Special, PS.nr.27/2019 i datës 23.12.2022, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m i

Historiku procedural

Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti Special, me aktgjykimin PS.nr.27/2019 i datës 23.12.2022, të akuzuarit B.A, H.H, A.H,V.SH, S.P, M.K, Xh.B, N.Sh, S.B, I.B, S.H, Sh.L, E.Ç, J.G, B.R, J.L dhe A.H për shkak të veprës penale secili veç e veç shpërlarje e parave (vepra penale në bashkim dhe vazhdimësi) në bashkëkryerje në kundërshtim me nenin 23 dhe 71 të KPRK-së, në fuqi deri me datë 31.12.2012, po ashtu e paraparë edhe në nenet 31 dhe 81 të Kodit të ri Penal të Kosovës në fuqi prej 01.01.2013, në kundërshtim me nenin 10 (2) të Rregullores së UNMIK-ut, nr. 2004/2 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe veprave penale të përafërta “, po ashtu në kundërshtim me nenin 32 të ligjit nr. 03/L-196 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit” në fuqi prej 30 shtator 2010, po ashtu e paraparë me nenin 56(1) të ligjit nr. 05/L-096”, Për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit “ në fuqi prej 15 qershor 2016, siç referohet në nenin 308 të KPRK-së, në fuqi prej 1 Janar 2013, lëshohet me datën 19.06.2023, në bazë nenit 364 par.1 nen par. 1.3 të KPPRK-së, i ka liruar nga akuza, pasi që nuk është provuar se të akuzuarit kanë kryer veprat penale për të cilat janë akuzuar.

Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ankesë ka ushtruar:

Prokurori i Prokurorisë Special të Republikës së Kosovës, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 të KPP-së, shkeljes së ligjit penal nga neni 385 i KPP-së dhe vërtetimit të gabuar ose jo të plotë të gjendjes faktike nga neni 386 i KPP-së, më propozim që Gjykata e Apelit e Kosovës, ta aprovoi ankesën si të bazuar dhe të marr aktvendim me të cilin do ta anuloj aktgjykim e ankimuar dhe çështjen t’ia kthej gjykatës së shkallës së parë

në rigjykim dhe vendim ose në alternativ të marrë aktgjykim me të cilin e ndryshon aktgjykim e ankimuar, ashtu që të akuzuarit t'i shpallë fajtor dhe të njëjtëve t'i shqiptoj dënimin e merituar.

Po ashtu, i propozojmë Gjykatës Apelit që në bazë të nenit 398, par. 2 të KPP-së, të urdhëroj gjykatën e shkallës së parë të caktoj një tjetër trup gjykues sipas një sistemi të caktimit të lëndëve që të jetë objektiv dhe transparent, për shkak se siç u elaborua detajish në këtë ankesë dhe duke marrë parasysh shkeljet e lartcekura, trupi gjykues që e ka gjykuar rastin, ka vlerësuar shumë gabimisht provat e rrjedhimisht mos caktimi i trupit tjetër gjykues do të rezultonte në keqpërdorim të drejtësisë.

Përgjigje në ankesën e PSRK-së, kanë parashtruar mbrojtësit e të akuzuarve B.A, av.Kujtim Kërveshi, V.SH, av.Hekuran Haxhimusa, J.G, av.Ibrahim Dobruna, J.L, av.Mustafë Radoniqi, S.B, av.Alban Makolli dhe i akuzuari I.B, me propozim që ankesa e PS të refuzohet si e pa bazuar ndërsa aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Prokuroria e Apelit me parashtrësën, PPA/I.nr.239/2023, datë 03.05.2023 ka propozuar që të aprovohet si e bazuar ankesa e Prokurorisë, ndërsa aktgjykimi i ankimuar të anulohet dhe çështja t'i kthehet shkallës së parë në rigjykim dhe vendim, apo të ndryshohet aktgjykimi i ankimuar ashtu që të akuzuarit të shpallën fajtor dhe t'iu shqiptohet dënim i merituar sipas ligjit, kurse përgjigjet në ankesën e PSRK-së, të ushtruara nga mbrojtësit e të akuzuarve B.A, av.Kujtim Kërveshi, V.SH, av.Hekuran Haxhimusa, J.G, av.Ibrahim Dobruna, J.L, av.Mustafë Radoniqi, S.B, av.Alban Makolli dhe i akuzuari I.B, të refuzohen si të pabazuara.

Gjykata e Apelit e caktoi dhe e mbajti seancën e kolegjit në pajtim me dispozitën e nenit 390 të KPPK-se në të cilën kanë marrë pjesë të akuzuarit B.A dhe mbrojtësi i tij Kujtim Kërveshi, mbrojtësi i të akuzuarit H.H me autorizim zëvendësues av.Pleurat Beka, i akuzuari A.H dhe mbrojtësi i tij me autorizim zëvendësues av.Lavdrim Salihu, mbrojtësja e të akuzuarit S.P, av.Teuta Zhinipotoku, N.Sh dhe mbrojtësi i tij av.Skender Morina, S.B dhe mbrojtësi i tij me autorizim zëvendësues av.Isuf Makolli, J.G dhe mbrojtësi i tij Ibrahim Dobruna, J.L dhe mbrojtësi i tij av.Mustafë Radoniqi dhe i akuzuari A.H, kurse Prokurori i Apelit dhe të akuzuarit H.H, V.SH, S.P, M.K, Xh.B, I.B Sh.L, E.Ç, B.R dhe S.H, dhe mbrojtësit av.Ali Beka, av.Ramiz Krasniqi (të cilët kanë dhënë autorizim zëvendësues), av. Hekurah Haxhimusa, av.Fetije Uka, av.Alban Makolli (ka dhënë autorizim zëvendësues), edhe pse kanë qenë të njoftuar në mënyrë të rregullt nuk morën pjesë në seancë. Mbrojtësit e të akuzuarve pasi elaboruan përgjigjet në ankesë theksuan se mbetën në tërësi pranë pretendimeve të ushtruara në përgjigjen në ankesë, dhe

kanë propozuar që ankesa e PSRK-së të refuzohet si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Vlerësimi i Gjykatës së Apelit

Gjykata e Apelit analizoi aktgjykimin e ankimuar, detyrimisht në kuptim të dispozitës së nenit 394 par.1 të KPPRK, vlerësoi pretendimet ankimore të Prokurorisë Speciale, përgjigjet e mbrojtësve të paraqitura për disa të akuzuar, dhe pas analizimit dhe vlerësimit të tyre gjeti se:

Ankesa nuk është e bazuar

Pretendimet ankimore të Prokurorisë Speciale

Në ankesë prokurori fillimisht ka sqaruar se çështja objekt i shqyrtimit në bazë të aktgjyimit të atakuar, është gjykuar dhe aktgjykimi është shpallur gjatë kohës kur kanë qenë në fuqi dispozitat ligjore të Kodit nr. 04/L-123 të procedurës Penale në fuqi deri më 16.02.2023, dispozita këto të cilave është dashur t'i përmbahet gjykata gjatë gjykimi të çështjes. Po ashtu prokurori në ankesë i është referuar dispozitave ligjore relevante të cilat konsiderohen si shkeljet esenciale të dispozitave të procedurë penale nga nenet 384, 370, 361, 364, 385, 386 dhe nën kuadër të këtyre dispozitave konsideron se aktgjykimin e atakuar gjykata e ka marrë me një mori shkeljesh dispozitave të lartcekura ligjore KPP-së, për të cilat thekson se do ti argumentoj në ankesë;

Ka theksuar se në aktakuzën e parashtruar nga PSRK, si palë të dëmtuara evidentuara nga PSRK (dhe të rekomanduara për tu ftuar në shqyrtim gjyqësor, ishin palët: familja P..., familja N... dhe A...K...P, ndërsa gjatë shqyrtimi gjyqësor, asnjëherë nuk ishte ftuar askush nga Institucioni i R.K i propozuar si palë e dëmtuar-A...K...P, edhe pse, në aktakuzë përveç së është dhënë rekomandimi për t'u ftuar ky Institucion shtetëror në shqyrtim gjyqësor, si palë e dëmtuar gjithashtu në arsyetimin e aktakuzës janë dhënë prova se pse konsiderohet si palë e dëmtuar. Prona publike e R. së K e cila ishte marrë përmes mashtrimeve dhe veprave të ndryshme penale nga grupi i organizuar kriminal i cili ndiqet sipas aktakuzës 1 në rastin me numër të njëjtë të lëndës, e transferuar më pas tek të pandehurit e kësaj çështje me qëllim që të maskonin origjinën e tyre kriminale.

Si palë e dëmtuara, prokurori po ashtu kishte identifikuar dhe rekomanduar që të ftohet në shqyrtim gjyqësor edhe familja P... me konkretisht, D.P, ose një anëtar i familjes P.... Megjithatë, gjykata në seancën e datës 21.04.2022, kishte obliguar PSRK-së, para seancës së

ardhshme t'i specifikojë-evidentojë se dëshmitar do dëgjohet këtë çështje penale, të evidentohet se cili prej tyre është dëshmitar relevant.

Në përgjigjen me shkrim të kësaj kërkesë të gjykatës, prokuroria e kishte përsëritur se emrat e dëshmitarëve të propozuar për t'u dëgjuar gjatë këtij shqyrtimi gjyqësor, e të cilët prokuroria i konsideron se janë dëshmitarë relevantë. Ndërsa në kërkesën e parashtruar për prokurorinë në të njëjtën seancë, gjykata kishte kërkuar të cekën adresat e dëshmitarëve, në mënyrë që t'iu dërgohen ftesat për seancën e radhës. Në përgjigje të kësaj kërkesë, prokuroria e kishte njoftuar gjykatën se, me dhënien e emrave dëshmitareve në aktakuzë, në pjesën e rekomandimit të proave, përfshihen edhe emrat e dëshmitarëve edhe deklaratat e dëshmitarëve të cilat janë marrë nga prokuroria, ku edhe janë dhënë në detaje adresat e dëshmitareve. Megjithatë, sipas kërkesës së gjykatës prokuroria sërish ka verifikuar adresat e dëshmitarëve të rekomanduar të dëgjohen si dëshmitarë dhe ia ka dërguar Gjykatës, kurse për palën e dëmtuar D.P, prokuroria e ka njoftuar gjykatën se deri me tani nuk kemi arritur t'i sigurojmë adresat e tyre por në momentin që do të sigurojmë do t'ua përcjellim ato.

Lidhur me këtë, Gjykata, jo vetëm që nuk kishte bërë asnjë përpjekje për të njoftuar palën e dëmtuar për pjesëmarrje në shqyrtim gjyqësor, por edhe në momentin kur ishte paraqitur vetë pala me kërkesën për të dëshmuar dhe për këtë kërkesë gjykata ishte njoftuar nga prokuroria, gjykata kishte refuzuar të dëgjoje përfaqësuesin e familjes P..... respektivisht të familjes së D.P, pa asnjë arsytim të dhënë ligjor.

Sa i përket shkeljes së dispozitave ligjore të KPP-së, që përcaktojnë rregullat e përpilimit të aktgjykimit prokuroria vlerëson se gjykata aktgjykim e ka marrë në shkelje të këtyre dispozitave duke qenë se aktgjykimi është i paqartë dhe i pakuptueshëm, ka një mospërputhje në mes të fakteve në dispozitiv dhe përmbajtjes së provave të përshkruara në arsytim, në arsytim të aktgjykimit nuk janë dhënë arsye të mjaftueshme dhe të qarta lidhur me faktet vendimtare të cilat gjykata i ka vërtetuar apo nuk i ka vërtetuar, arsytimi është në kundërshtim me provat e paraqitura dhe të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe arsytet në të cilat është bazuar me rastin e vendosjes së kësaj çështjeje penale dhe përgjegjësisë penale të të pandehurve. Dispozitivi i lexuar së bashku me arsytimin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë nuk ofron një vlerësim gjithëpërfshirës të provave si dhe një vërtetim të gjendjes faktike.

Nga arsytimi i aktgjykimit rezulton se pasi përshkruhen fjalët përfundimtare të palëve, gjykata për secilin nga të pandehurit shënon deklarinimin e dhënë në mbrojtje të tyre, duke filluar me

fjalinë gjykata e vlerëson mbrojtjen e të pandehurit B.A të dhënë në shqyrtimin gjyqësor, ku ka deklaruar dhe vlerësimi i gjykatës në fund të përshkrimit të deklaratës secilit nga të pandehurit vijon; ashtu që të gjitha këto rrethana krijojnë besueshmëri të shkallës së lartë, se këto paluajtshmëri janë regjistruar në regjistrat kadastral, konform dispozitave ligjor në fuqi, andaj gjykata vlerëson se mbrojtja e të pandehurit B.A është e sinqertë, objektive dhe e bazuar në fakte dhe prova që gjenden në shkresat e lëndës.

Sipas prokurorisë një përshkrim i tillë i deklaratës së secilit nga të pandehurit, me një konkludim të paarsyetuar se përse gjykata ia fal besimin asaj dëshmie e jo dëshmive të paraqitura nga prokuroria, nuk është në pajtim me dispozitën ligjore të nenit 370 të KPP-së, në bazë të të cilit është përcaktuar përmbajtja dhe forma e aktgjykimit me shkrim.

Më tej, në arsyetim të aktgjykimit të atakuar, gjykata, përveç përshkrimit të dispozitës ligjore të nenit 7 të KPP-së dhe tutje i referohet kësaj dispozite ligjore duke theksuar se gjykata realisht vetëm me arsyetim të ngjashëm si në pjesën paraprake të aktgjykimit, ku përshkruan provat-deklaratat e dëshmitarëve të propozuar nga prokurori e të dëgjuar nga prokurori i shtetit gjatë shqyrtimit gjyqësor, me vlerësimin prej një fjalie të vetme se: “(Gjykata ka vlerësuar dëshminë e këtij dëshmitari mirëpo të njëjtat nuk i gjeti relevante për vërtetimin e ndonjë fakti të rëndësishëm në këtë çështje penale)”.

Ndërsa sa i përket disa dëshmitarëve, gjykata në pjesën arsyetuese vijon duke i përshkruar deklaratat e dëshmitarëve të propozuar nga prokurori e të dëgjuar gjatë shqyrtimit gjyqësor, me vlerësimin prej një fjalie të vetme se: “Gjykata ka vlerësuar dëshmitë e këtij dëshmitari, mirëpo të njëjtat nuk i gjete relevante në vërtetimin e ndonjë fakti të rëndësishëm për shkak se dëshmitari i lartcekur në deklaratat e tij përmend vetëm të akuzuarit në rastin T.....”.

Ngjashëm gjykata bënë vlerësimin edhe të dëshmitarëve si në vijim: deklaratat e dëshmitarëve G., J... S, të dyja të dëgjuara gjatë shqyrtimit gjyqësor, pasi përshkruan se çfarë kanë deklaruar, vlerëson me një fjali të vetme se “Gjykata gjenë se në këto deklarata bëhet fjalë për parcellën nr..... në pronësi të pandehurit A.H, ku vërtetohej se i njëjti nuk ka pas njohuri për historinë e kësaj parcele dhe e ka blerë duke i ndjekur procedurat ligjore, ka lidhur kontrate për shitblerjen e palujtshemrisë se lidhur në mes F.G- shitës dhe blerësi A.H, është vërtetuar në Gjykatën Komonale, dhe e ka bartë pronësi pa asnjë pengese, apo në rastin e dëshmitarit M.S “Gjykata ka vlerësuar dëshmitë e këtij dëshmitari gjykata nuk vlerëson me tej autorizimin e lartcekur për arsye se për këtë provë akuzohen të pandehurit në rastin “T...” dhe provë nuk është

relevante për vërtetimin e ndonjë fakti të rëndësishëm në këtë çështje penale. Në rastin e dëshmisë së dëshmitarit M.J sërish kufizohet në vlerësimin e dëshmisë me një fjali të vetme pas përshkrimit të deklaratës, se “Gjykata gjenë se e njëjta deklaratë gjenë mbështetje në provat materiale si parakontrata, kontrata, pagesat bankare, në deklaratën e të pandehurit M.K, andaj gjykata e vlerëson dëshminë e dëshmitarit si objektive, reale dhe të sigurtë, ku vërteton gjendjen faktike sa i përket të pandehurit M.K.

Gjithashtu, gjykata bënë vlerësimin edhe dy dëshmitarëve N.A dhe J.M, pasi përshkruan se çfarë kishin deklaruar këta dy dëshmitarë, kufizohet në vlerësimin me një fjali të vetme se “Gjykata ka vlerësuar dëshminë e këtij dëshmitari, mirëpo të njëjtat nuk i gjeti relevante në vërtetimin e ndonjë fakti të rëndësishëm në këtë çështje penale pasi që parcelanuk është objekt i kësaj çështjeje penale”.

Prokurori thekson se të gjitha provat e cekura si më lartë, që ishin propozuar me paraqitjen e aktakuzës dhe të cilat ishin administruar gjatë shqyrtimit gjyqësor, nuk janë vlerësuar fare nga gjykata, në formën siç e kërkojnë dispozitat ligjore të KPP-së, por në aktgjykimin e atakuar, gjykata vetëm ka bërë një përshkrim të tyre duke i pasuar me një fjali të vetme se “nuk ishin relevante”, “janë relevante për rastin T...” apo “vërtetojnë faktin se mes të pandehurit dhe shitësit të akuzuar në T... kishte pasur kontratë formale, transaksion bankar dhe bartje të pronësisë”.

Nisur nga fakti se lidhja e kontratave ishte bërë në formë të shkruar apo se pagesa e dëshmuar përmes transaksioneve bankare apo se bartja e pronësisë ishte arritur të bëhet në emër të të pandehurit, gjykata ka arritur në konkludimin se këto e bëjnë deklaratën e të pandehurve të sigurtë, me besueshmëri të lartë, objektive dhe të bazuar në prova, pa i vlerësuar saktësinë e provave kundërthënëse, dhe argumentet e prokurorisë se ishin pikërisht këto veprime të pandehurve si mjete të përdorura me qëllim të fshehjes apo të maskimit të natyrës dhe burimit të prejardhjes së pasurisë që realisht ishte fituar nga një aktivitet i dëshmuar kriminal.

Faktet e tilla, në ndërlidhje me të gjitha provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor, jo vetëm që nuk shmangin përgjegjësinë penale të të pandehurve në kryerjen e veprës penale shpërlarje e parasë nga të pandehurit, por, ashtu siç është argumentuar nga prokuroria e cila kishte mbledhur këto prova për të dëshmuar *modus operandi* të të pandehurve, janë dëshmi se të pandehurit kanë kryer veprën penale për të cilën akuzohen. Për më tepër gjykata fare nuk lëshohet në vlerësimin e provave që prokuroria kishte siguruar gjatë fazës së hetimeve dhe i ka

paraqitur dhe administruar gjatë gjykimit, në bazë të të cilave prova prokuroria kishte provuar se blerësit në rast secili nga të pandehurit e lartcekur, nuk ishin blerës me mirëbesim por realisht ishin përgjegjës për veprën penale shpëlarje parave.

Ngjashëm si vlerësimin e deklaratave të dëshmitarëve, gjykata e bënë edhe vlerësimin e provave materiale të paraqitura nga prokuroria duke u kufizuar në vlerësimin me një fjali të vetmë “Gjykata i vlerëson këto prova dhe i vlerëson të gjitha raportet e cekura si më poshtë ... por gjykata gjenë se të gjitha raportet e përgjimeve, procesverbalet mbi kontrollin e personave dhe banesës, aktvendimet, certifikatat e lartcekura, janë prova që kanë bëjnë për të pandehurit në çështjen penale me rastin T..... andaj gjykata nuk bën vlerësimin e provave të njëjta pasi që nuk kanë relevancë në këtë çështje penale.

Po ashtu prokuroria vlerëson se në bazë të interpretimeve të gabuara në rastin konkret të ligjeve të së drejtës civile, gjykata në aktgjykimin e ankimuar kishte konstatuar se “gjykata konstaton se nuk është detyrë e blerësve për ta vërtetuar prejardhjen e ligjshme të pronës, ngase kjo vërtetohet përmes institucioneve relevante të sistemit juridik të një shteti, dhe në radhë të parë duke filluar nga të dhënat kadastrale ku janë të regjistruar pronarët e paluajtshmërive, dhe këto regjistra janë publik, ashtu që ekzistimi i cilës apo të gjitha këtyre rrethanave të lartcekura objektivisht e përjashtojnë dijeninë e palës me interes juridik, se në ato paluajtshmëri ka diçka kontestuese a kundërligjore”.

Një konstatim të tillë gjykata e sjellë pa iu përgjigjur pretendimeve të prokurorisë dhe provave të ofruara për secilin nga të pandehurit, të cilat prova dëshmojnë se të pandehurit ishin përfshirë në shitblerjet e pronave thjeshtë për të fshehur përfitimin e krimit, ku blerësit janë ose figura që janë të caktuar në mënyrë specifike për të vepruar, ose mashtrues, prandaj ata konsiderohen bashkëkryerës të veprës penale të pastrimit të parave. Kjo do të thotë se, prokuroria ka argumentuar edhe përmes aktakuzës, edhe përmes fjalës hyrëse të paraqitur në fillim të këtij shqyrtimi gjyqësor, përmes provave të administruara dhe argumenteve të dhëna në fjalën përfundimtare në përfundim të këtij gjykimi, se gjatë hetimit të këtij rasti prokuroria kishte vërtetuar se kishin ndodhur tri lloje të transferimit të pronës objekt i aktakuzës së parë dhe aktakuzës së dytë, dhe atë; 1) Shitja mashtruese e ndërmarrë thjeshtë për të fshehur përfitimin e krimit, ku blerësit janë ose figura që janë të caktuar në mënyrë specifike për të vepruar, ose mashtrues, prandaj ata janë bashkëkryerës të veprës penale të pastrimit të parave; 2) Shitjet e vërteta ku blerësit janë në dijeni, që aseti është përfitim i krimit, prandaj ata blejnë në një çmim

të konsiderueshëm nën vlerën e tregut dhe janë bashkëkryerës të veprës penale të pastrimit të parave; 3) Shitjet e vërteta ku blerësit nuk janë në dijeni, ose nuk kanë arsye për të qenë në dijeni, që aseti është përfitim i krimit, prandaj ata blejnë në çmim që është koherent me vlerën e tregut, janë të besueshëm dhe nuk mund të konsiderohen bashkëkryerës të veprës penale të pastrimit të parave.

Me të gjitha provat e administruara gjatë këtij shqyrtimi gjyqësor, prokuroria kishte dokumentuar se të akuzuarit e lartcekur, nuk i takonin grupit të tretë të përshkruar lartë, prandaj edhe ishin akuzuar nga prokuroria, duke qenë se ishin përfshirë në shitblerjet e pronave thjeshtë për të fshehur përfitimin e krimit, ku blerësit janë ose figura që janë të caktuar në mënyrë specifike për të vepruar, ose mashtrues, prandaj ata konsiderohen kryes të veprës penale të pastrimit parave.

Ndërsa gjykata, duke mos vlerësuar çdo provë një nga një dhe në lidhje me provat sjellë konstatimin se “Nëse do të ishte kështu, pra sipas prokurorisë bazuar në kriterin e çmimit të shitblerjes së paluajtshmërive, do të ekzistonte përgjegjësi penale në radhë të parë për të gjithë noterët që kanë përpiluar dhe vërtetuar kontrata të tilla, dhe për të gjithë personat zyrtarë që punojnë në drejtorinë kadastrale, e të cilët ua kanë mundësuar atyre personave regjistrimin e paluajtshmërive në pronësinë e tyre në regjistrat kadastral, mirëpo krahasim të cilin e bënë gjykata nuk është i duhur, pasi që sipas prokurorisë nga provat e lartcekura të akuzuarit e kanë ditur apo kanë mundur ta dinë se parcelat e tokës janë në pronësi shoqërore për të cilat ata kishin hyrë në raporte shitblerjeje ishin fitim i krijuar me aktivitete kriminale.

Se gjykata e ka marrë aktgjykimin e atakuar në shkelje të dispozitave të procedurës penale, dëshmon edhe fakti se, në disa pjesë të arsyetimit të aktgjykimit, fare nuk është marrë me vlerësim e provave të gjatë shqyrtimit gjyqësor, por i referohet provave të cilat nuk dihet se nga e kanë burimin, meqenëse nuk janë prova të siguruar nga prokuroria e as të siguruar nga gjykata sipas detyrës zyrtare, ndërsa në anën tjetër ka kundërshtuar provat e paraqitura nga prokuroria që në cilësinë e dëshmitarit të dëmtuarit të dëgjohet përfaqësuesi i familjes P....

Bazuar në të lartcekurat gjykata, përveç dështimit që të vërtetojë faktet vendimtare që kanë të bëjnë me veprën penale për të cilën akuzohen të pandehurit, e njëjta nuk jep asnjë arsye të qëndrueshme se përse dispozitat ligjore të caktuara të ligjit penal, e që ishin ato të paraqitura në aktakuzën e prokurorisë, nuk ishin aplikuar të akuzuarve dhe veprave të tyre. Kurse lidhur me veprën penale vetëm përshkruan dispozitën ligjore që sanksionon veprën penale të shpërlarjes

së parave, me arsyetimin se në rastin konkret nuk jenë përmbush asnjëra nga elemente qenësore të kësaj vepre penale, për kundër faktit se prokuroria ka ofruar prova lidhur me veprat penale për të cilat akuzohen të pandehurit, dhe ka analizuar rolet individuale dhe veprimet kriminale të secilit të akuzuar.

Prokurori i Shtetit edhe në aktakuzë, por edhe gjatë gjithë shqyrtimit gjyqësor, i ka rikujtuar gjykatës se, të pandehurit në këtë çështje penale, nuk konsiderohen anëtarë të grupit të organizuar kriminal për të cilën akuzohen të pandehurit në “Aktakuzën e parë apo ndryshe të quajtur T...”. Të akuzuarit në bazë të kësaj aktakuze, ishin individë që kishin lidhje të ngushta familjare, personale ose të biznesit me anëtarët e grupit të cilët ndiqen sipas aktakuzës së parë apo “T.....”. Këta individë nuk kishin vepruar në mënyrë të pavarur dhe me qëllim të vërtetë për të blerë pronat për vete, por pas kërkesës së anëtarit të grupit të organizuar kriminal ata ishin ndërlidhur në këtë.

Sipas provave të paraqitura nga prokuroria dhe të administruara në shqyrtim gjyqësor, fillimisht grupi i organizuar kriminal ishte në gjendje që me veprime kriminale të merrte pronësinë e parcelave të tokës të regjistruar si pronë shoqërore e Republikës së Kosovës, përmes mjeteve dhe veprimeve kriminale. Më pas, grupi shiti tokat drejtpërdrejtë në njërin nga dy mënyrat. Së pari, grupi kreu shitjet e rrejshme duke transferuar pronësinë e tokës tek anëtarët e grupit, ose së dyti, anëtarët e grupit ua shitën tokën drejtpërdrejtë palëve të treta. Parcelat u transferuan disa herë në mënyrë që të maskonin/fshihnin origjinën e tyre kriminale. Shumë nga shitjet ishin thjeshtë shitje të rrejshme ku blerësit nuk kishin kapacitete ekonomike për t'i blerë asetet dhe çmimi i shitjes ishte jashtëzakonisht nën vlerën e tregut dhe kjo konsiderohet shpërlarje e parave.

Sa i përket konfiskimit të pasurisë që është objekt i kësaj çështje penale thekson se prokuroria kishte paraqitur kërkesën për konfiskimin e pasurisë, bazën ligjore si dhe argumentet ligjore për konfiskimin e paluajtshmërive objekt i kësaj çështjeje ligjore dhe se një kërkesë të tillë e kishte përsëritur me rastin e paraqitjes së fjalës hyrëse, fjalës përfundimtare dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor. Lidhur me këtë në dispozitiv të aktgjykimit gjykata ka marrë vendim për anulimin e pjesërishëm të Urdhërësës se lëshuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë PPP..., duke cekur se: “Pas plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi, titullarëve të këtyre paluajtshmërive-pronarëve iu lejohe disponimi me të gjitha autorizimet që burojnë nga të drejtat pronëse për këto ngastra kadastrale; palët e dëmtuara: familja P..., familja N..., A...P....K, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest të rregullt juridiko-civil’.

Një vendim të tillë, gjykata e ka marrë pa asnjë arsytim, ashtu siç e obligon dispozita ligjore e lartpërmendur, përveç udhëzimit të palëve në kontest të rregullt juridike civil dhe përshkrimit të emërtimit të parcelave, në pjesën e arsytimit të aktgjykimit gjykata kësaj pikë i bënë një përshkrim të plotë arsytimit që kishte dhënë në aktvendimin e marrë para fillimit të shqyrtimit gjyqësor në këtë çështje penale. Andaj një vendim i tillë i marrë në bazë të aktgjykimit të atakuar, jo vetëm se është i kundërligjshëm por edhe i cenon parimet e shtetit ligjor, sepse është shenjë që tregon se grupe kriminale mund të tjetërsojnë pronën shtetërore përmes dokumenteve të falsifikuara dhe ta shesin atë pa frikë se e njëjta më vonë do të konfiskohet dhe do t'i kthehet shtetit.

Prandaj konfiskimi i të ardhurave nga krimi, i kërkuar nga prokuroria është i domosdoshëm dhe i detyrueshëm, aq më tepër kur e njëjta gjykatë, nga provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor, kishte vërtetuar faktin se këto paluajtshmëri janë bartur në emër të personave të tretë përmes falsifikimit të dokumenteve. Përveç kësaj asetet të cilat aktualisht janë liruar nga sekuestrimi të përkohshëm vlerësohen nga ekspertët në vlerë prej miliona euro. Këto prona të vlefshme janë pa dyshim përfitime nga veprat penale përmes falsifikimit të dokumenteve dhe pastaj janë bartur në emër të të pandehurve.

Pretendimet e mbrojtësve të të akuzuarve në përgjigjen në ankesën e PSRK

Mbrojtësi i të akuzuarit B.A, av Kujtim Kërveshi, në përgjigjen në ankesën thekson se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, nuk ka të bëjë me shkelje të dispozitave ligjore siç pretendon prokuroria për faktin se vetë prokuroria e çështjes përmend se është me e drejtë të thuhet grup i organizuar kriminal i cili ndiqet në pjesën T...., sesa të thuhet se ndiqet sipas aktakuzës 1 për faktin se kemi të bëjmë me një aktakuzë të njëjtë si në rastin T.... dhe në raste të tjera pa asnjë ndryshim të vetëm. Po ashtu mbrojtja konsideron se palët e dëmtuara sipas propozimet të prokurorisë së çështjes në aktakuzë është e mjaftueshëm të jenë prezent në rastin T.... dhe nuk është e nevojshëm që në këtë rast të ndarë të ftohën palët e dëmtuara përsëri, për shkakun se mjafton që palët e dëmtuara të kenë mundësin në një pjesë ti realizojnë të drejtat e tyre. Përveç kësaj prokuroria gjatë shqyrtimit gjyqësor në asnjë moment nuk ka qenë në gjendje që ti ndaj dëshmitarët relevant për tu dëgjuar në këtë pjesë po ashtu nuk ka qenë në gjendje të jap shpjegim se pse dëshmitarët e ftuar janë relevant për tu dëgjuar. Tutje mbrojtja konsideron se gjykata e shkallës së parë, ka vlerësuar drejtë provat në lidhje me të akuzuarin B.A, në lidhje me mjetet e mjaftueshme për blerjen e dy parcelave për të cilat akuzohet. Duke propozuar që Gjykata e Apelit të refuzojë ankesën e ushtruar nga Prokurorja e çështjes si të pa bazuar.

Mbrojtësi i të akuzuarit J.G, av.Ibrahim Z. Dobruna, në përgjigjen në ankesën thekson se nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të prokurorisë dhe se gjykata e shkallës së parë në aktgjykimin e ankimuar, e ka mbështetur në analizën ligjore, duke vlerësuar çdo provë veç e veç, dhe ka nxjerrë përfundimin se nuk është provuar deri më tani se i akuzuari ka kryer veprën penale me të cilën akuzohet. Ka shtuar se pretendimet e prokurorit janë pretendim retorike të përgjithësuara dhe nuk identifikojnë shkelje të dispozitave procedurale nga gjykata pasi që në rastin konkret prokuroria nuk ka ofruar prova për të gjetur përgjegjësin për asnjë veprë penale të pretenduara mbi bazën e se cilës do të arsyetohej akuza.

Mbrojtësi i të akuzuarit S.B, av.Alban Makolli, përgjigjen në ankesën thekson konsideron se asnjë nga pretendimet ankimore të ngritura nga PSRK, nuk qëndrojnë, dhe se aktgjykimi i ankimuar në tërësi është i drejtë dhe i bazuar në ligj, pasi që janë vlerësuar drejtë provat në të cilat mbështet aktakuza, pas të cilit vlerësim, ka ardhur në përfundim se nuk janë të mjaftueshme të njëjtat për të përmbushur dyshimin e bazuar mirë se është kryer vepra penale dhe se për krejt këto janë arsye të mjaftueshme në aktgjykim. Ka shtuar se gjykata ka dhënë arsye për secilën provë në raport me të mbrojturin e tij se i njëjti për blerjen e asaj prone ka marr kredi të ardhurat kanë qenë të ligjshëm dhe çmimi ka qenë në përputhej me tregun, andaj pretendimi i prokurores është i pa qëndrueshëm dhe kundërthënës, për arsye të lartcekura ka propozuar që aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Mbrojtësi i të akuzuarit J.L, av.Mustafa Radoniqi, në përgjigje në ankesë, konsideron se ankesa e ushtruar nga PSRK, është pabazë ligjore, kurse aktgjykimi i atakuar është i drejtë dhe i ligjshëm, ndërsa cilësimi juridik i aktakuzës është në tërësi i paqartë dhe i papërcaktuar, andaj ka propozuar që aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Mbrojtësi i të akuzuarit V.SH, av.Hekuran Haxhimusa, në përgjigje në ankesë, konsideron se ankesa e Prokurorisë Speciale është në tërësi e pabazuar pasi që në ankesë nuk është dhënë ndonjë arsyetim që vendimi i gjykatës së shkallës së parë është i pabazuar. Në ankesë prokuroria vetë ka theksuar se ekzistojnë prova të mjaftueshme për të mbështetur akuzën ngase shumica e blerësve nuk kishin kapacitet ekonomik për ti blerë këto prona dhe kjo përbënë shperlarje të parave. Ndërsa lidhur me këtë gjykata ka dhënë arsyetim juridik dhe plotësisht të bazuar me gjendjen e fakteve, se kontratat e shitblerjeve të këtyre palujtshmerive janë vërtetuar në organet gjyqësore dhe janë regjistruar sipas procedurës ligjore në regjistrat kadastral. Me tutje ankesa e ushtruar nga PSRK-ja, është bazuar kryesisht, në faktin se nuk janë marrë për bazë dëshmitë e dëshmitarëve, kurse nga procesverbalet e shqyrtimit gjyqësor, kuptohet se këta dëshmitarë nuk

kanë pasur të bëjnë me çështjen penale e cila ka qenë objekt akuzës, andaj nuk qëndrojnë pretendimet ankimore dhe propozon që aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

I akuzuari I.B, në përgjigje në ankesë, konsideron se ankesa e prokurorisë është e pabazuar, e cila me tepër merret me propozimet e bërë lidhur me dëgjimin e dëshmitarëve pa specifikuar se cila ishte rëndësia dhe nevoja e dëgjimit të këtyre dëshmitarëve të dëmtuarve në raport me të akuzuarin I.B. Ka shtuar se gjykata në vendimin e marrë, e ka analizuar çdo provë, në lidhje me provat e tjera, ku me të cilat nuk është provuar se i njëjti ka kryer veprën penale me të cilën akuzohet. Andaj gjykata në mënyrë profesionale ka dhënë arsye të mjaftuara për secilin provë dhe nuk ka bërë shkelje të dispozitave procedurale, duke nxjerrë aktgjykim të drejtë dhe të bazuar në ligj.

Të gjeturat e Gjykatës së Apelit

Gjykata e Apelit, vlerëson se pretendimet e lartë cekura ankimore nuk qëndrojnë e as që ka shkelje të tjera të dispozitave të procedurës penale, për të cilat, sipas detyrës zyrtare kujdeset kjo gjykatë, e të cilat kishin me kushtëzuar anulimin e aktgjykimit të ankimuar.

Aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1 lidhur me nenin 369 të KPRK-së, e të cilave u referohet në ankesë prokurori, ngase dispozitivi i aktgjykimit është i kuptueshëm, në të nuk ka kundërthënie me vetveten e as me arsyet e tij, është i qartë dhe konkret. Aktgjykimi i kundërshtuar përmban arsyet e duhura mbi të gjitha faktet relevante të kësaj çështje penale.

Gjithashtu kjo gjykatë vlerëson se pretendimet e prokurorit se aktgjykimi i ankimuar nuk përmban arsye të mjaftueshme dhe të qarta lidhur me faktet vendimtare të cilat gjykata i ka vërtetuar apo nuk i ka vërtetuar dhe se arsyetimi është në kundërshtim me provat e paraqitura dhe të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor, kjo gjykatë i ka vlerësuar si të pabazuara ngase gjykata e shkallës së parë drejtë ka vërtetuar se nga dispozitivi i akuzës nuk rezulton të jenë të përfshirë veprime inkriminuese përkatësisht faktet dhe rrethanat që do të përbenin element e kësaj vepre penale, pasi që prokuroria në këtë drejtim nuk ka ofruar prova se blerësit e këtyre paluajtshmërive tani të pandehurit nga B.A, deri të i pandehuri A.H, të kenë pasur çfarëdo lidhje subjektive me të akuzuarit e pjesës tjetër të aktakuzës T...., përmes të cilave prova do të provohet fakti se të akuzuarit e kanë ditur, apo kanë mund të ishin në dijeni, se vendimi gjyqësor, regjistri kadastral e fletet poseduese nga të pandehurit në çështjes penale T..., si Sh.S, F.G, E.G, Sh.M, E.U, I.S, ishin siguruar në mënyrë të kundërligjshme me kryerjen e aktiviteteve kriminale, apo

nëse ka ekzistuar ndonjë marrëveshje paraprake për pastrimin e parave. Pra gjykata e shkallës së parë ka bërë analizën e të gjitha provave të procedura gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe lidhur me to ka paraqitur konkludimet e veta, të cilat si të drejta objektive, dhe të ligjshme, i aprovon edhe kjo gjykatë.

Pretendimi prokurorit se aktgjykimi ankimuar është marrë me një mori shkeljesh esenciale, ndër to ka qenë rekomandimi për dëgjimin e palëve të dëmtuara si: familja P..., familja N... dhe A...K...P, ndërsa gjatë shqyrtimi gjyqësor, asnjëherë nuk ishte ftuar askush nga Institucioni i Republikës së Kosovës i propozuar si palë e dëmtuar-A...K...P, edhe pse, në aktakuzë përveç së është dhënë rekomandimi për t'u ftuar ky Institucion shtetëror në shqyrtim gjyqësor, në arsyetimin e aktakuzës janë dhënë prova se pse konsiderohet si palë e dëmtuar. Prokurori në rastin konkret në mënyrë të përgjithësuar i është referuar të dëmtuarve të lartcekur pa specifikuar se cila ishte nevoja dhe arsyeja e këtyre dëshmitarëve-të dëmtuarave që lidhin relevancën e fakteve që lidhen me veprimet apo mos veprimet e të akuzuarve.

Pretendimet e prokurorit se aktgjykimi ankimuar nuk është i qartë dhe nuk është arsyetuar mjaftueshëm, nuk janë dhënë arsye për faktet vendimtare lidhur me veprimet konkrete për secilin të akuzuar, por gjykata ka bërë parafrzim të përgjithshëm duke konstatuar se në rastin konkret nuk ka prova të mjaftueshme për të mbështetur dyshimin e bazuar se të njëjtit kanë kryer veprën penale.

Gjithashtu janë pretendime të përgjithësuar pasi që nga prokuroria nuk identifikohet qartë dhe saktë se cila është shkelja esenciale nga gjykata dhe cili është fakti i pretenduar me relevancë që përmban shkelje.

Të gjeturat për vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike.

Prokurori e ankimon aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, duke shtuar se aktgjykimin të gjykatës së shkallës së parë nuk ofron një vlerësim gjithëpërfshirës të provave si dhe një vërtetim të plotë të gjendjes faktike.

Gjykata e Apelit gjen se pretendimet ankimore të Prokurorit nuk qëndrojnë, ngase nga faktet dhe provat e çështjes konstatohet se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë nga ana e gjykatës së shkallës së parë, dhe se në këtë aspekt asnjë fakt nuk ka ngelur në mëdyshje sikurse pretendohet në ankesën e ushtruar. Nuk është provuar se të akuzuarit e kanë kryer veprën

penale të përshkruara si në përshkrimin faktik të dispozitivit të aktgjykimit të ankimuar, gjykata e shkallës së parë administroi në shqyrtimin gjyqësor provat dhe dëshmitë si në vijim:

Deklarata e dëshmitareve të dhëna në shqyrtim gjyqësor; N.H, B.K, G.S, J.S, V. N....., M.S, V, D.L, S.K R.B, F.M, H.C, F.R, M.J, N.A, deklaratat e dëshmitareve të dhëna në policin e Eulex-it; J.M, Sh.S, deklaratat e dëshmitareve N.B dhe F.P të dhënë gjatë mundësisë hetues të veçantë, deklaratat e dëshmitareve Zh.V, B.V, dhe S.M, M.M, S.R.S të dhëna përmes ndihmës juridike ndërkombëtare dhe B.S të dhënë në policinë Eulex-it, si dhe provave materiale si;

I. Provat materiale që dalin nga Urdhëri për regjistrim të thirrjeve telefonike dhe porosive tekstuale SMS, sipas urdhëresës së i GJTH P..., me numër PPS; Raporti i dytë 15 ditor, i Policisë së Eulex-it-Njësia për Hetimin e Krimit të Organizuar, Nr.dosjes: (.....). Në këtë periudhë të raportimit të linjave telefonike të përgjuara është një bisedë fikse e përgjuar në burgun e D.... e cila tregon se F.Gësthtë duke përdorur viber për të komunikuar jashtë burgut; Raporti i gjashtë 15 ditor, i Policisë së Eulex-it-Njësia për Hetimin e Krimit të Organizuar, Nr dosjes: (datë). Në këtë periudhë të raportimit janë regjistruara disa biseda relevante për hetimet. Njëra nga bashkëshortet e të pandehurit F... – E.B është tani në kontakt me një grua me emrin të pandehurën L.S; Raportet 15 ditore për vazhdimin (miratuar me datë 10.12.2015) për urdhrin për përgjim i datës 12.08.2015 (katër numrave telefonik të grave) Urdhëri për përgjimin e numrave të telefonit, është lëshuar me datë, është vazhduar me datë dhe është ripërtërirë për herë të tretë me datë; Raporti i Policisë së Eulex-it-Njësia për Hetimin e Krimit të Organizuar, Nr.dosjes:, datë (datë).

Në këtë periudhë zhvillohen disa biseda relevante ku F.Gi cili ishte ende në Spitalin e Prishtinës dhe ai me ndihmën e familjarëve dhe shokëve të tij organizonte shitjen e tokave në Sh.....; Raporti i Policisë së Eulex-it-Njësia për Hetimin e Krimit të Organizuar, Nr dosjes:, datë (datë). Në këtë Raport zhvillohen disa biseda telefonike, F...., ende ishte në Spitalin e Prishtinës, mirëpo në ato biseda shihet se familjarët e tij janë të përfshirë në shitjen e banesave; Raportet 15 ditore për përgjimet të linjës telefonike të D..... Urdhëri për përgjimin e numrit të telefonit (nr fiks) i cili është i vendosur në Spitalin e Burgut të D....., i cili Urdhër është lëshuar me datë, si dhe 3 raporte 15 ditore të specifikuara si më poshtë; Raporti i parë 15 ditor, i Policisë së Eulex-it-Njësia për Hetimin e Krimit të Organizuar, Nr dosjes:, datë (datë). Në bisedat telefonike të datës, ora dhe me datë, ora 16:13:37, i pandehuri Sh.S fletë me persona të panjohur PPM rreth shitjes 25 ari t.....; Raporti i dytë 15

ditor, i Policisë së Eulex-it-Njësia për Hetimin e Krimit të Organizuar, Nr dosjes:, datë (datë 0.....).

Në këtë Raport zhvillohen disa biseda telefonike, ku i pandehuri Sh.S..... disa biseda telefonike, ku me datë 19.01.2016, ora 18:29:32 dhe datë 20.01.2016, ora 16:13:37, komunikon me personin e panjohur PPM për shitjen e 25 ari truall ku i pandehuri i thotë se toka është në emrin e tij dhe dokumentet do të ia dërgoj i biri i tij; Raporti i tretë 15 ditor, i Policisë së Eulex-it-Njësia për Hetimin e Krimit të Organizuar, Nr dosjes:, datë 01/03/2016 (datë 07.04.2016). Në këtë Raport zhvillohen disa biseda telefonike ku i pandehuri Sh.Sme ndihmën e djalit të tij L..... dhe avokatit aplikon për lirim me kusht; Raportet 15 ditore për vazhdimin e përgjimeve të linjës së D...., në lidhje me numrin e telefonit (linjë fikse); Raporti i pestë 15 ditor, i Policisë së Eulex-it-Njësia për Hetimin e Krimit të Organizuar, Nr dosjes:, datë 28/03/2016 (datë 07.04.2016). Në këtë periudhë janë zhvilluar disa biseda në mes të Sh. S. dhe djalit të tij L... ku përmenden disa çështje lidhur me një CD (audio-incizimi i siguar nga F.G); Raportet 15 ditore për vazhdimin e përgjimeve të linjës së D...., në lidhje me numrin e telefonit(linjë fikse); Raporti i gjashtë 15 ditor, i Policisë së Eulex-it-Njësia për Hetimin e Krimit të Organizuar, Nr dosjes:, datë 12/04/2016. Gjatë kësaj periudhe të përgjimeve në këtë Raport i pandehuri Sh.Sshpesh merret me biznesin e tokave; Raporti i shtatë 15 ditor, i Policisë së Eulex-it-Njësia për Hetimin e Krimit të Organizuar, Nr dosjes:, datë 27/04/2016.

Gjatë kësaj periudhe të përgjimeve në këtë Raport zhvillohen disa biseda ndërmjet Sh.S dhe familjarëve të tij lidhur me artikujt aktual të shtypit dhe arrestimet e mundshme të A.S; Raportet 15 ditore për vazhdimin e përgjimeve të linjës së D.... në lidhje me numrin e telefonit (linjë fikse); Raporti i parë 15 ditor, i Policisë së Eulex-it-Njësia për Hetimin e Krimit të Organizuar, Nr dosjes:, datë 23/03/2016. (datë 07.04.2016). Gjatë kësaj periudhe janë regjistruar disa biseda relevante ndërmjet nga D.H i cili ishte duke u përpjekur që të i shes 10 apo 30 ari tokë në V.....; Raporti i katërt 15 ditor, i Policisë së Eulex-it-Njësia për Hetimin e Krimit të Organizuar, Nr.dosjes: datë 07/05/2016. Në këtë periudhë të përgjimit zhvillohen disa biseda ku shihet se përpjekja e D.H ku planifikon përmes personave të tjerë që ta ndihmojë që të dal nga burgu; Raporti i tretë 15 ditor, i Policisë së Eulex-it-Njësia për Hetimin e Krimit të Organizuar, Nr dosjes: datë 22/04/2016. Në këtë periudhë janë regjistruar biseda ndërmjet D.H dhe disa bashkëbiseduesve, të gjitha lidhur mirë me njëri-tjetrin për të i kryer bizneset apo marrëveshjet e paluajtshmërive që i rregullojnë problemet që ndërlidhen me çështjet e D.; Raportet 15 ditore i përgjimit të telekomunikimeve, i datë 31.05.2016, të linjës së D.... në lidhje me numrin e telefonit(linjë fikse); Raporti i pestë 15 ditor, i Policisë së

Eulex-it-Njësia për Hetimin e Krimit të Organizuar, Nr dosjes:, datë 31/05/2016 (datë 01.06.2016). Në këtë periudhë të raportimit D.... në disa biseda telefonike, i informon bashkëbiseduesit që mos të bisedojnë përmes linjës fikse se telefoni është duke u përgjuar; Procesverbalet mbi kontrollin e personave dhe banesës, datë 27.04.2016 ndaj H.B, datë 27.04.2016, ndaj emrin të dyshuarit I.S (shtëpia e Sh. S), me datë 27.04.2016 ndaj Sh.U, datë 27.04.2016 ndaj F.G, datë 27.04.2016 ndaj N.U, datë 27.04.2016 ndaj S.H, datë 27.04.2016 ndaj G.G, datë 27.04.2016 ndaj R.U, datë 27.04.2016 ndaj A.M datë 27.04.2016 ndaj N.B.-Aktvendim - Agjencia Kadastrale e Kosovës, nr. protokollit:, datë 27.04.2016 ZK: P....., aprovohet kërkesa e Gjykatës Themelore P....., e cila ka të bëjë me Sekuestrimin e Përkohshëm të së drejtës së pronës së paluajtshme për parcelat kadastrale me nr,, që gjenden në ZK. Prishtinë. Lista e pronave të evidentuara në A...K...K, janë sekuestruar me Urdhëresën për sekuestrim me nr. PPR....., PPS.nr....., datë 26.04.2016; Nga Certifikatë - Agjencia Kadastrale-njësia e lëndës, datë 27.04.2006, Komuna P..., Zona Kadastrale – P..., në emër të Pronarit-poseduesit, H.S.B, në të cilat janë të përfshira këto parcela; Procesverbal mbi kontrollin e personave dhe banesës ndaj L.S me datë 27.04.2016, S.M me datë 27.04.2016, N.P me datë 27.04.2016, R.M me datë 27.04.2016, F.G me datë 27.04.2016, Sh.S me datë 27.04.2016, Sh.U me datë 27.04.2016; Raport i DPK – NJHKO Njësia e TI Forenzikës mbi ekzaminimin e provave të sekuestruara me nr të rastit në Njësinë e TI Forenzikës, datë 28.09.2016, nga të pandehurit A.S, A.V, F.G, N.P, si dhe E.G.

Gjykata e shkallës së parë ka gjetur se të gjitha raportet e përgjimeve, procesverbalet mbi kontrollin e personave dhe banesës, Aktvendimet, certifikata e lartcekura janë prova që kanë të bëjnë për të pandehurin në çështjen penale me rastin T..., sipas gjykatës nuk provojnë fakte të cilat kanë të bëjnë me çështjen penale që është objekt shqyrtimi, si të tilla nuk kanë relevanc në këtë çështje penale.

II. Provat materiale që dalin nga Urdhri për zbulimin e të dhënave financiare, të Gjykatës Themelore në P..., PPS, datë Raporti i parë 15 ditor, i Policisë së Eulex-it-Njësia për Hetimin e Krimit të Organizuar, Nr dosjes:, datë 29/08/2016, për zbulimin e të dhënave financiare për të pandehurin V.S, gjykata e shkallës së parë ka gjetur se këto prova i përkasin çështjes penale në rastin T..., e njëjta prova nuk ka as një relevanc në këtë çështje penale; Nga raporti i Policisë së Eulex-it-Ekipi Charlie NJHKO, Referencë:, datë 26.08.2016. Raporti i përkohshëm i Policisë së Eulex-it-Ekipi C.....NJHKO, lidhur me F.P, nr i rastit, nr i regjistrimit, datë 02.09.2016, gjykata e shkallës së parë ka gjetur se këto prova i përkasin çështjes penale në rastin T..., e njëjta prova nuk ka as një relevanc në këtë çështje penale.

371. Opshtinski Sud u Prishtini. –Presudu-, P. Br., P.V – S.M.M, datum 24.06.1992 godine, zaključeno izedju V..... K. B..... iz Kosovo Polja i Poljoprivrednog Industrijskog Kombinata “K.....E.....” iz Prishtine Nistav, P. Br., dt. 24.06.1992, kjo shkresë është aktgjykimi P.br....., i shkallës së parë i nxjerr nga kryetarja e trupit gjykues M.M, me këtë aktgjykim i është aprovuar kërkesë padia e prokurorit publik komunal në Prishtinë dhe vërtetohet se kontrata është Nule, për shitblerjen e patundshmërisë së V..... K. B....nga Fushë Kosova dhe Industrijskog Kombinata “K.....E.....” nga P..... Përmes këtij aktgjykimi ju njihet e drejta për kthimin e tokës në pronësi për parcelën numër me sipërfaqe ... ha ... ari dhe parcela me sipërfaqe .. ha e ... ari e ...m2, të cilat janë të regjistruara në numrin zona kadastrale Prishtinë.

Po ashtu gjykata ka bërë vlerësimin e të gjitha kontratave të shitblerjes në mesë shitësve dhe blerësve, siç janë:

305. A.H - Vlerësohen Kontrata numri i librit inter përcjellës, me datë 10.10.2007.

306. Kontratë mbi shit-blerjen e lidhur me datë 09.09.2007 në mes të pandehurit F.G (shitës) dhe A.H (blerës), Certifikata mbi pronësinë, vërtetime Pagesa përmes bankave për blerje te pronësisë, aktvendimi dhe dokumentacioni i bashkangjitur.

Kontrata mbi shit-blerjen e pronës, e lidhur në Prishtinë, datë 05.09.2007, në mes të F.G (shitës) dhe A.H (blerës) ku shitësi ia shet ngastrën kadastrale në Llapllasellë në vendin e quajtur F.....Gj..... e kulturës bujqësore, e që evidentohet sipas numrit të certifikatës UL-....., ngastra kadastrale P-..... në sipërfaqe prej ha, në çmim prej € dhe Vërtetimi i Gjykatës Komunale në Prishtinë, Vr.nr., datë 07.09.2007, Urdhër transferi i P..... Bank, datë 07.09.2007.

Shpallje Publike për zbatimin e ndërrimeve në regjistrin e të drejtave mbi pronat e paluajtshme- Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronësi, formulari nr... data e shpalljes 14.09.2007, data e mbylljes 20.09.2007, pronari i mëparshëm M.B, Zona Kadastrale Q....., nr. parcelës, vendi i quajtur are, e drejta që regjistrohet kontratë, pronari i tanishëm J.Sh, i mëparshëm N.N, nr. parcelës i tanishëm I.Y, i mëparshëm A.R, Zona Kadastrale B. Epërme, nr. parcelës, i tanishëm R.B, i mëparshëm P.I, Zona Kadastrale P....., nr. parcelës i tanishëm K.N, L.S, Zona Kadastrale B. Epërme, nr. parcelës, D.Z, A.D, Zona Kadastrale M....., nr. parcelës, D.R, Z.N, Zona Kadastrale Q....., nr. parcelës, A.O, F.G, Zona Kadastrale Ll....., nr. parcelës, A.H, R.Q, Zona Kadastrale M....., nr. parcelës, N.R, A.Q, nr. parcelës, N.R, M.R Zona Kadastrale Q....., nr. parcelës, N.M, G.D, Zona Kadastrale nr. parcelës, G.D, H.K, Zona Kadastrale P....., nr. parcelës, A.B.

Shkresa Aktvendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës - Ministria e Shërbimeve Publike- Agjencia Kadastrale e Kosovës, nr. lëndës-protokollit, Komuna Prishtinë, Zona Kadastrale Ll....., formulari nr., dt.21.09.2007, ku merret Aktvendim dhe Aprovohet Kërkesa e A.H, e cila ka të bëjë me bartjen nga parcela kadastrale nr..... ZK Ll..... Komuna Prishtinë; Shkresa e Qeverisë së Republikës së Kosovës - Ministria e Shërbimeve Publike - Agjencia Kadastrale e Kosovës, Kërkesë për regjistrimin e paluajtshmërisë, nr. protokollit datë 22.09.2007, Komuna Prishtinë, A.H (parashtrues i kërkesës, pronar i mëparshëm F.G, nr njësisë, vendi i quajtur F.....Gj....., lloji i kulturës bujqësore, sipërfaqja; Nga Kopja e planit e datës 18.03.2008, e lëshuar nga Komuna e Prishtinës, Drejtorati për Kadastër dhe Gjeodezi, vërtetohet se ngastra me numër e cila ka gjithsej ari e metra katror dhe e cila është F.....Gj....., gjendet në Zonën Kadastrale në Ll..... në emër të pronarëve H.A.

Gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar Certifikatën me numër fiskal, në emër të N.T. ‘L.....O.....’ SH.P.K., e datës 08.10.2009 dhe nga e njëjta vërtetohet se ky biznes është i regjistruar si SH.P.K. – Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, mban numër fiskal dhe adresa e këtij biznesi është në Zonën Industriale (P.....- F.....K.....) P.....

Nga Çertifikata e regjistrimit për TVSH, në emër të N.T. ‘L.....O.....’, SH.P.K., e datës 05.07.2007, vërtetohet se ky biznes është regjistruar me datë 25.11.2004 dhe numri i regjistrimit të tij është, me status deklarues i TVSH-së, ndërsa adresa e këtij biznesi është P....., P....., Zona Industriale (P.....-F.....K.....); Nga shkresa e Agjencionit për regjistrimin e Bizneseve e cila i është drejtuar A.H dhe G.H, vërtetohet se secili kanë pjesëmarrje në pronë me nga000.00 Euro; Nga Raporti i qarkullimit bankar i lëshuar nga P.....B..... për

periudhën 01.01.2007 deri me datë 31.12.2007 për N.T. I.....O..... SH.P.K, vërtetohet se ky biznes ka pasur qarkullim bankar në shumë prej Euro.

Gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar nga Agjencioni për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës dhe nga e njëjta ka vërtetuar se ‘I.....O.....’ SH.P.K, në këtë agjencion është i regjistruar me datë 25.11.2004 si Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me kapital gjithsej prej000.00 Euro, ku drejtor gjeneral është A.H me pjesëmarrje prej000.00 Euro të kapitalit, R.H me pjesëmarrje prej000.00 euro të kapitalit dhe G.H me pjesëmarrje prej000.00 Euro të kapitalit. Për më tepër nga e njëjta vërtetohet se ky biznes si primar ka Tregtinë me shumicë të pijeve, ndërsa sekondare ka tregtinë me shumicë jo të specializuar, por e njëjta merret edhe me tregti të tjera, pas vlerësimit të provave të lartcekura gjykata gjen se i pandehuri A.H fillimisht ka lidhur kontratën mbi shit-blerjen me F.G si shitës, ndërsa i pandehuri A.H si blerës, ka marrë certifikatën mbi pronësinë e parcelës, pagesat për blerjen parcelës së lartcekur i ka bërë përmes bankave, ku në bazë të provave të lartcekura biznesin e tij gjatë vitit 2007, ka pas qarkullim të mjaftueshëm të parave për ta blerë parcelën pasi që kontrata është lidhur me 5 shtator 2006, parcelën e tokës nr., në L.....S..... nga F.G në çmim prej € (..... € për m²), sipas të lartcekurave gjykata e shkallës së parë ka ardhur në përfundim se nuk qëndron pretendimi i prokurorisë se nuk dihet prejardhja e parave që të pandehurit në këtë çështje penale që i kanë blerë parcelat, andaj në rrethanat e lartcekura kur e ka bërë blerjen e pronësisë mbi parcelën pa as një pengesë ligjore dhe konform dispozitave ligjore, është vërtetuar se i njëjtit nuk ka qenë në dijeni për historianit e parcelës dhe ka qenë blerës me mirëbesim.

313. B.A Vlerësohen Kontrata numri i librit inter përcjellës, me datë 15.06.2006, Aktvendim bartje të parcelës, me datë 26.05.2006.

314. Kontratë mbi shit-blerjen e patundshmërisë, Kontratë e lidhur me datë 23.05.2006, në mes të shitësve S.G, S.N, S.J, S.G dhe blerësit B.A, certifikata mbi pronësinë me datë 04.28.2006, kërkesë për regjistrimin e paligjshmërisë nr. protokollit

Gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar formularin e deklaramit vjetor dhe pagesës për tatimin në të ardhura personale për periudhën e vitit 2005 dhe nga i njëjti ka vërtetuar faktin se i pandehuri B.A – në biznesin e tij NTP ‘B.....’ ka pas qarkullim Euro, prej të cilave fitimi ka qenë Euro ndërsa shuma e tatimit të paguar është Euro.

Gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar Deklaratën Tatimore në fitim për vitin 2003-2004, në të cilën vërtetohet se i pandehuri B.A si pronar i NTP “B.....” ka pas qarkullim në shumë prej

..... Euro, ndërsa shuma e tatimit të paguar është Euro, pas vlerësimit të provave të lartcekura gjykata gjen se i pandehuri B.A fillimisht ka lidhur kontratën mbi shit-blerjen mes shitësve S.G, S.N, S.J, S.G, ku përfaqëson E.G avokat me autorizim vr. Nr., në një të anë si shitës, ndërsa i pandehuri B.A si blerës, ka marrë certifikatën mbi pronësinë e parcelave të lartcekura, ku në bazë të provave të lartcekura biznesin e tij NTP 'B.....', gjatë viteve 2003-2004-2005 ka pas qarkullim të mjaftueshëm të parave për ta blerë parcelat pasi që kontrata është lidhur me datë 24 maj 2006, parcelat e tokës nr.dhe në L.....S..... nga shitësi E.G, i cili kishte vepruar në cilësi të përfaqësuesit dhe në emër të anëtarëve të familjes S....., në çmim prej000 € (..... € për m²), andaj sipas së gjykatës së shkallës së parë nuk qëndron pretendimi i prokurorisë se nuk dihet prejardhja e parave që të pandehurit në këtë çështje penale që i kanë blerë parcelat, andaj në rrethanat e lartcekura kur e ka bërë blerjen e pronësisë mbi parcelat pa as një pengesë ligjore dhe konform dispozitave ligjore, është vërtetuar se i njëjtit nuk ka qenë në dijeni për historiatin e parcelës dhe ka qenë blerës me mirëbesim.

322. Kontrata për shitblerje të patundshmërisë, shitës E.H, blerës I.B kontratë për bartje Numri i librit inter përcjellës me datë 23.08.2012, Kontratë mbi shit-blerjen e patundshmërisë me datë 25.07.2017 Shitësi-E.U Blerësi I.B, certifikata mbi pronësinë, aktvendimet me data 14.08.2012.

Gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar Vërtetimin mbi kontributet e stazhit pensional e i validor, me numër, i datës 01.11.2022, i lëshuar nga Komuna e P....., Drejtoria për Ekonomi e Financa, Sektori i të Hyrave Publike në emër të Y.B babai i të pandehurit I.B dhe nga i njëjti vërtetohet se Y.B nga Prizreni në emër të firmës Sh....., i cili ka ushtruar veprimtarinë e prodhimit të shamive, ka filluar pagimin e kontributeve pensionale nga data 12.07.1983 deri me datë 31.12.1998, ku gjithsejtë shuma e paguar e kontributeve në fjalë është Dinar.

Gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar Vërtetimin mbi kontributet e stazhit pensional e i validor, me numër i datës 01.11.2022, i lëshuar nga Komuna e P.....t, Drejtoria për Ekonomi e Financa, Sektori i të Hyrave Publike në emër të I.B dhe nga i njëjti vërtetohet se I.B nga Prizreni, i cili ka ushtruar veprimtarinë e prodhimit të shamive, ka filluar pagimin e kontributeve pensionale nga data 01.01.1971 deri me datë 12.07.1983, ku gjithsej shuma e paguar e kontributeve në fjalë është00 Dinar.

Janë vlerësuar transaksionet bankare të lëshuara nga R.....B....., në periudhën nga data 01.01.2004 deri me datë 31.12.2012 për I.B dhe nga e njëjta ka vërtetuar se gjatë kësaj periudhe

i njëjti nga kjo bankë ka marrë kredi në vlera të ndryshme duke filluar prej shumës00 Euro e deri në vlera shumë të vogla të parave.

Janë vlerësuar transaksionet bankare të lëshuara nga T.....B....., për I.B dhe nga e njëjta vërtetohet se në periudhën prej 27.09.2010 deri më 31.12.2010 ka marrë kredi në shumë prej00 Euro; për periudhën 01.01.2011 deri më 31.12.2011 nga kjo bankë ka marrë kredi në shumë prej Euro, ku gjatë kësaj periudhe i njëjti kredinë prej Euro e ka marrë për të bërë pagesën për blerje të parcelës NR ZK P..... nga A.M; për periudhën 01.01.2012 deri më 31.12.2012 ka marrë kredi në vlera të ndryshme duke filluar nga00 e deri në vlera më të vogla; për periudhën 01.01.2013 deri me datë 31.12.2013 nga kjo bankë ka marrë kredi në shumën prej00 Euro; për periudhën 01.01.2014 deri më 31.12.2014 nga kjo bankë ka marrë kredi në shumë prej Euro; për periudhën 01.01.2015 deri më 31.12.2015 në shumë prej Euro, pas vlerësimit të provave të lartcekura gjykata gjen se i pandehuri I.B fillimisht ka lidhur kontratën mbi shit-blerjen me shitësen E.H, ndërsa i pandehuri I.B si blerës, ka marrë certifikatën mbi pronësinë e parcelës të lartcekur, ku në bazë të provave të lartcekura, gjatë viteve 2010-2015 ka pas qarkullim të mjaftueshëm të parave për ta blerë parcelat pasi që kontrata është lidhur me datë 14 gusht 2012, parcelën nr. në V..... nga shitësja E.U në çmim prej000 € (..... € për m2).

Andaj sipas aktgjykimit të atakuar nuk qëndron pretendimi i prokurorisë se nuk dihet prejardhja e parave që të pandehurit në këtë çështje penale që i kanë blerë parcelat, andaj në rrethanat e lartcekura kur është bërë bartja e pronësisë mbi parcelat pa pengesa ligjore dhe konform dispozitave ligjore, është vërtetuar se të njëjtit nuk ka qenë në dijeni për historiatin e parcelës dhe ka qenë blerës me mirëbesim.

336. Vlerësohen Kontrata për këmbim (ndërrim prone) J.G kontratë –Ndërrim për Bartje Numri i librit inter përcjellës me datë 29.01.2013, Kontratë – Këmbimi me numër rend..... nr. ref..... me datë 08.01.2013 Këmbyesi i parë- Ndërmarrja e Re K.... - J.G, Këmbyesi i dytë I.S, certifikata mbi pronësinë, aktvendimet me data 22.01.2013.

Deklarata mbi transferimin nga Agjencia Kosovare e Mirëbesimit, të pronës së patundshme të NPSH ‘D..... (e njohur gjithashtu edhe si D.D. Y..... D.....) në Ndërmarrjen e re K.... L.L.C., me numër e datës 10 Qershor 2008 dhe nga e njëjta ka vërtetuar se përmes kësaj deklarate, Agjencia Kosovare e Mirëbesimit në përputhje me rregulloret e AKM-së, ka bërë ekzekutimin e saj mbi transferimin e Pronës së Patundshme të NPSH ‘D.....’ në Ndërmarrjen e Re K.... L.L.C. me numër të regjistrimit të biznesit, një kompani e inkorporuar nën ligjet

e Kosovës, me blerës J.G, me gjitha të drejtat dhe titullin e NPSH- së dhe interesin ndaj pronës së patundshme prej NPSH-së tek Kompania.

327. Kontratë për shitblerje të patundshmërisë, shitës Ndërmarrja e Re K...., blerësi B.R kontratë për Bartje Numri i librit inter përcjellës me datë 08.04.2013, Kontratë mbi shit-blerjen e patundshmërisë me numër rend. nr. ref. ,me datë 09.11.2007, Shitësi Ndërmarrja e Re K.... Blerësi B.R, certifikata mbi pronësinë, aktvendimet me data 02.04.2013.

331. Kontratë për shitblerje të patundshmërisë, shitës B.R, blerës F.G kontratë për Bartje Numri i librit inter përcjellës me datë 03.04.2016, Kontratë mbi shit-blerjen e patundshmërisë me numër rend. nr. ref. ,me datë 22.10.2014 Shitësi B.R Blerës F.G, çertifikata mbi pronësinë, aktvendimet me data 07.04.2016, E drejta mbi pronat e paluajtshme, pagesa nga bankë.

Pas vlerësimit të provave të lartcekura gjykata e shkallë së parë ka gjetur se i fillimisht kanë lidhur Kontratë – Këmbimi me numër rend. nr. ref..... me datë 08.01.2013 Këmbyesi i parë- Ndërmarrja e Re K.... - J.G, Këmbyesi i dytë I.S, me datë 31 tetor 2012, ku i pandehuri J.G me datë 8 janar 2013, ai ka lidhur marrëveshje me I.S dhe ndërmarrjen e tij “Ndërmarrja e Re K....”, nëpërmjet të cilës i është miratuar e drejta pronësore mbi parcelën e tokës nr., në V....., kalon në pronësi të tij pa pengesa ligjore, ku me datë 4 mars 2013, duke përfaqësuar “Ndërmarrjen e Re K....”, i pandehuri J.G parcelën e tokës nr. në V..... ja shet B.R, në një çmim prej000 € (..... € për m2), me sa duket paguar me mjetin motorik në vend të parave, ku i pandehuri B.R, ka bërë bartjen e pronësisë mbi parcelën pa as një pengesë ligjore dhe konform dispozitave ligjore, dhe të njëjtën parcele me datë 22.10.2014, i’a ka shitur F.G, është vërtetuar se të pandehurit e lartcekur nuk ka qenë në dijeni për historiatin e parcelës së lartcekur dhe ka qenë blerës me mirëbesim.

Kontrata mbi shit-blerjen e patundshmërisë, e lidhur në P....., datë 09.07.2007, në mes të K.B (shitës) dhe V.SH (blerës), ku shitësi ia shet paluajtshmërinë e cila është e regjistruar në flete poseduese nr. UL-..... ZK Ll....., si ngastër kadastrale nr., në sipërfaqe prej ha të cilën ia shet blerësit në çmimin prej € dhe Vërtetimi i Gjykatës Komunale në Prishtinë, Vr.nr....., datë 09.07.2007; Fletëpagesa e N.....K.....,, datë 09.07.2007, V.SH, Sh.S.

Shkresa e Qeverisë së Republikës së Kosovës - Ministria e Shërbimeve Publike - Agjencia Kadastrale e Kosovës, Kërkesë për regjistrimin e paluajtshmërisë, nr. protokollit, Zona

Kadastrale Ll....., Komuna P....., V.SH (parashtrues i kërkesës, pronar i mëparshëm B.K.M, nr njësisë, vendi i quajtur Sh.P, lloji i kulturës bujqësore, sipërfaqja ha, datë 31.07.2007; Shkresa Aktvendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës- Ministria e Shërbimeve Publike-Agjencia Kadastrale e Kosovës, nr. lëndës-protokollit, Komuna Prishtinë, Zona Kadastrale Ll..... formulari nr..... datë 09.08.2007, ku merret Aktvendim dhe Aprovohet Kërkesa e V.SH, e cila ka të bëjë me bartjen nga parcela kadastrale nr. ZK Ll....., Komuna P.....

Nga Kopja e Planit e datës 26.07.2007 e lëshuar nga Drejtorati për Kadastër dhe Gjeodezi, gjykata ka vërtetuar se ngastra kadastrale me numër, me kulturë bujqësore, në vendin Sh.P, ka .. ari emetra katror, dhe e njëjta gjendet në Komunën Kadastrale në Ll....., me numër Fletëposedimi, me numër plani 10 dhe është në emër të pronarit B.K.M

340. Kontrata për shitblerje të patundshmërisë, shitës V.SH blerës S.P Kontratë për Bartje Numri i librit inter përcjellë me datë 03.12.2007, Kontratë mbi shit-blejten e patundshmërisë me datë 18.09.2007 , Shitësi V.SH Blerës S.P, çertifikata mbi pronësinë, aktvendimet me data 30.10.2007 pagesa nga banka.

Nga Raporti i Qarkullimit Bankar i lëshuar nga P....C....B.... për periudhën 01.01.2007 deri më 31.10.2007 për N.T.P. ‘P....., vërtetohet se biznes i familjes i të pandehurit S.P ka pas qarkullim bankar në shumë prej Euro.

Gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar Fletëpagesën në shumë prej000 Euro, e lëshuar nga P...C.....B..... e datës 18.10.2007 dhe nga e njëjta ka vërtetuar se N.T.P. P..... përmes llogarisë së tij bankare i ka transferuar V.SH shumën prej000 Euro, si pagesë për blerjen e truallit në zonën kadastrale Ll.ë në Sh..... sipas nrvr. Nr. i parcelës

Fletëpagesën në shumën prej000 Euro, e lëshuar nga P...C.....B..... e datës 19.09.2007 dhe nga e njëjta ka vërtetuar se N.T.P. P..... përmes llogarisë së tij bankare i ka transferuar V.SH shumën prej000 Euro, si pagesë për blerjen e truallit në Zonën Kadastrale Ll.ë në Sh.P sipas nrvr, nr. i parcelës

Raporti i Qarkullimit bankar i lëshuar nga P....C....B..... i datës 12.09.2007 për N.P vllau i të pandehurit S.P dhe nga e njëjta vërtetohet se i njëjti në llogarinë e kursimeve ka Euro, ndërsa në llogarinë rrjedhëse ka00 Euro, pas vlerësimit të provave të lartcekura gjykata e shkallës së parë ka gjetur se është lidhur Kontratë mbi shit-blejten e patundshmërisë në mes të K.B shitës dhe V.SH blerës, ku me datë 09 korrik 2007, parcelën e tokës nr. në L....S.....

nga shitësi Sh.S, i cili kishte vepruar në cilësi të përfaqësuesit dhe në emër të K.B, në çmim prej € (..... € m2), e ka blerë parcelën e pandehuri V.SH, ku pagesën për parcelë e ka bërë përmes bankës, ka bërë bartjen e pronësisë mbi parcelën pa as një pengesë ligjore dhe konform dispozitave ligjore, është vërtetuar se të njëjtit nuk ka qenë në dijeni për historiatin e parcelës, ku i njëjtit me datë 18.09.2007 ka lidhur Kontratë mbi shit-blerjen e patundshmërisë, Shitësi V.SH, Blerës S.P, certifikata mbi pronësinë, aktvendimet me data 30.10.2007, ku në bazë të provave të lartcekura nga i pandehuri S.P fletëpagesën e çmimit të kontratës janë bërë përmes bankës, pasi që me datë 30 tetor 2007, parcelën e tokës nr.në L.....S..... e ka blerë nga shitësi V.SH, në çmim prej,000 € (..... € m2), andaj në rrethanat e lartcekura kur e ka bërë bartjen e pronësisë mbi parcelat pa as një pengesë ligjore dhe konform dispozitave ligjore, është vërtetuar se i njëjtit nuk ka qenë në dijeni për historiatin e parcelës dhe ka qenë blerës me mirëbesim.

342. Kontrata për shitblerje të patundshmërisë, shitës B.A, blerës H.H aplikues për Bartje Numri i librit inter përcjellë me datë 15.11.2006 Kontratë mbi shit-blerjen e patundshmërisë me datë 18.10.2006, shitësi B.A blerës H.H, Certifikata mbi pronësinë, aktvendimet me data 01.11.2006 pagesa nga banka.

Gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar edhe fletëpagesën e çmimit të kontratës e vërtetuar në Gjykatën Komunale e datës 18.10.2006 e lidhur në mes shitësit B.A dhe blerësit H.H, e bërë përmes bankës, për periudhën kohore 01.01.2003-31.12.2006 dhe nga e njëjta vërtetohet se H.H i ka paguar shumën prej,000.00 Euro për blerjen e tokës nr. i parcelave të pandehurit B.A,

Marrëveshja për dhënien me qira të stendës në treg, me numër e datës 05.10.2000 dhe nga e njëjta është vërtetuar se kjo marrëveshje është lidhur në mes të Ndërmarrjes Publike Komunale “T.....” në P..... e re prezantuar nga drejtori H.K si qiradhënës dhe H.H si qiramarrës, për dhënien e me qira të stendës me numërnë sipërfaqe prejm katror, në tregun e P....., P.....R.....P..... Për më tepër nga e njëjta është vërtetuar se qiraja për këtë stendë ka qenë në periudhë kohore prej 12 muajve, duke filluar prej datës 01.10.2000 dhe duke përfunduar me datë 01.10.2001. Pas vlerësimit të provave të lartcekura gjykata e shkallës së parë ka gjetur se i pandehuri H.H fillimisht ka lidhur kontratën mbi shit-blerjen mes shitësit B.A, ndërsa i pandehuri H.H si blerës, ka marrë certifikatën mbi pronësinë e parcelave të lartcekura, ku në bazë të provave të lartcekura fletëpagesën e çmimit të kontratës janë bërë përmes bankës, pasi që kontrata është lidhur me datë 18 tetor 2006, parcelat e tokës nr.

dhe në L.....S..... nga shitësi B.A me çmim prej000 €, (..... për m2), andaj në rrethanat e lartcekura kur e ka bërë barjeten e pronësisë mbi parcelat pa as një pengesë ligjore dhe konform dispozitave ligjore, është vërtetuar se i njëjtit nuk ka qenë në dijeni për historiatin e parcelës dhe ka qenë blerës me mirëbesim.

323. Kontratë për shitblerje të patundshmërisë, shitës I.S, blerësi E.Ç kontratë për Bartje, Numri i librit inter përcjellës me datë 30.08.2012, Kontratë mbi shit-blerjen e patundshmërisë me datë 09/08.2012 Shitësi – I.S Blerësi E.Ç, çertifikata mbi pronësinë, aktvendimet me data 24.08.2012.

330. Kontratë për shitblerje të patundshmërisë, shitës E.Ç, blerës E.Z kontratë për Bartje Numri i librit inter përcjellës me datë 10.03.2016, Kontratë mbi shit-blerjen e patundshmërisë me numër rend. nr. ref. ,me datë 25.02.2016 Shitësi E.Ç Blerës E.Z, Certifikata mbi pronësinë, e drejta mbi pronat e paluajtshme, pagesa nga banka.

329. Kontratë për shitblerje të patundshmërisë, shitës E.Ç, blerës A.H kontratë për Bartje Numri i librit inter përcjellës me datë 18.05.2015, Kontratë mbi shit-blerjen e patundshmërisë me numër rend. nr. ref. 191/04, me datë 07.04.2015 Shitësi E.Ç Blerës J.L dhe A.H, Certifikata mbi pronësinë, aktvendimet me data 14.05.2015, E drejta mbi pronat e paluajtshme, pagesa nga banka.

380. Kontratë mbi shitblerjen e patundshmërisë e lidhur në mes të shitësit I.S, dhe blerësi-Sh.L, njësia kadastrale P-LLLLLLLLL, në vendin e quajtur “P.....” me sipërfaqe m2, e noterizuar tek noteri I.A, LRP. Nr., Ref. datë 31.08.2006. Shkresat nga pika vërtetojnë se i pandehuri Sh.S(është në cilësi të pandehurit te rasti T...), ia kishte shitur Sh.L, parcelën me nr. P-....., me datë 16.11.2012.

363. Kërkesa për Regjistrimin e palujtshmërisë nr....., E.Rr.Ç, Prishtinë, nr i prtok.,

364. Kontratë mbi shitblerjen e patundshmërisë e lidhur në mes shitësit Sh.L – dhe blerësit E.Ç, ZK P....., me nr. ref., certifikata e pronësisë P-....., me sipërfaqe m2, lloji i njësisë “P.....”, vendi i quajtur “P.....”, e vërtetuar tek noteri I.A, Ref. LPR nr.,ref..... me datë 26.06.2013 .

365. Aktvendim - Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadaster, nr. protokollit: ZK: P....., aprovet kërkesa E.Ç, e cila ka të bëjë me bartje të pronës së palujtshmërisë ngastra kadastrale

nr., me sipërfaqem², kontrata e për shitblerjen e palujshmërive e vërtetuar tek noteri I.A LPR. Nr. , datë 26.07.2013.

Shkresat nga pikat, vërtetojnë se të pandehurit I.S dhe E.U (janë në cilësi të pandehurve të rasti T...), kishin shitur parcelat,,, dhe tek blerësit dhe në fund blerësit i kishin bartur këto prona në emër të tyre, gjykata e shkallës së parë ka gjetur se blerës i parcelës janë të pandehurit Sh.L, J.L dhe A.H, andaj në rastin konkret gjykata e shkallës së parë vlerëson se të pandehurit Sh.L, J.L dhe A.H nuk kanë pasur njohuri për historiatin e parcelës, blerja nga ana e të njëjtëve është bërë me mirëbesim.

Gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar Aktvendimin e Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme, të Gjykatës Supreme, me numër AC-I-..... i datës 26.11.2015 dhe nga i njëjti vërtetohet se ky kolegji, ka vendosur që ankesa e Agjencisë Kosovare e Privatizimit kundër Aktvendimit të Kolegjit të Specializuar i DHPGJS-së, C-III..... i datës 15.09.2015 është e bazuar, ndërsa ka anuluar aktvendimin e ankimuar të Kolegjit të Specializuar si të pa saktë në rezultat dhe i pabazuar në ligj dhe se me anë të këtij Aktvendimi kjo gjykatë ka hudhur poshtë si të pa pranueshme kërkesën e paditësit për lëshimin e masës së përkohshme.

Është vlerësuar transaksionin bankar i lëshuar nga P...C.....B....., i datës 27.06.2016 për J.L dhe i njëjti vërtetohet se J.L gjatë muajve janar, shkurt dhe mars të vitit 2015, nga kjo bankë ka marrë disa herë kredi në shuma të ndryshme, duke filluar nga shuma00 Euro deri të shumat me të vogla.

Marrëveshjen mbi Kredi Personale nr..... e lidhur me datë 30.06.2015 në P....., në mes të “R.....B.....K.....” J.S.C. si kredi dhënës dhe J.L si kredi marrës dhe nga e njëjta vërtetohet se J.L djali i të pandehurit J.L nga kjo bankë, ka marrë kredi në shumën prej00 Euro, për kthimin e saj në afat prej 84 muaj, me kamatë prej 7.5% në vit.

Gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar planin e amortizimit i lëshuar nga N....., në emër të A.L dhe J.L dhe nga i njëjti vërtetohet se A.L, djali i të pandehurit J.L, nga kjo bankë ka marrë kredi në shumë prej000, 00 Euro, me normë të interesit 7.8%, me numër 45 të kësteve, ku data e arritjes së këstit të parë është 01.04.2015 ndërsa data e arritjes së këstit të fundit është 01.12.2018, ndërkaq J.L nga kjo bankë ka marrë kredi në shumë prej, me normë të interesit 9.8%, me numër të kësteve 44, ku data e arritjes së këstit të parë është 15.02.2015 ndërsa data e arritjes së këstit të fundit është 15.09.2018.

Është vlerësuar gjendja e përgjithshme të deklarimeve dhe transaksioneve tjera e lëshuar nga Administrata Tatimore e Kosovës lidhur me biznesin N.SH. ‘T..F.....C.....K.....’ me nr. Fisak dhe nga i njëjti vërtetohet se te ky biznes Totali për tatim për është (qarkullim); -.....(obligim); (pagesa);(bilanci).

Gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar Raportin kreditor për Sh.L, i datës 04.06.2021, i lëshuar nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës dhe nga i njëjti vërtetohet se sipas Ekspozimit total përfshirë edhe kreditë e ndërlidhura, numri total i kredive aktive është 1 (një), shuma totale e miratuar është000.00 Euro, shuma totale e kësteve mujore është 0.00 =, shuma totale e mbetur është Euro dhe shuma totale e vonuar është Euro.

378. Certificate- Agjencia Kadastrale - numri i lëndës, datë 29.01.2013, P....., Pronari – poseduesi / Sh.L, lagja “Q.....” sipërfaqjam2.

379. Deklaratë nën betim, Ref, :L.R.P. nr. në të cilën vërtetohet se I.S në emër të çmimit të shitblerjes së parcelës kadastrale të evidentuar në certifikatën e pronësisë ZK. P..... P-....., në vendin e quajtur “P.....” në sipër.m2, pjesa e pronës 1/1, do ti paguaj Sh.L, shumën prej €, e noterizuar tek noteri I.A. Gjykata e ka vlerësuar Deklaratën nën betim dhe nga e njëjta vërtetohet se I.S pranë Noterit I.A me vullnet të lirë ka dhënë këtë deklaratë me të cilën vërtetohet se në emër të çmimit të shitblerjes së parcelës kadastrale të evidentuar në certifikatën e pronësisë, lëshuar nga Agjencioni Kadastral i Kosovës, Zyra Kadastrale Prishtinë, me nr. të njësisë kadastrale P-....., Zona Kadastrale Prishtinë, Komuna Prishtinë, lloji i njësisë, parcelë, zonë rurale, lloji i shfrytëzimit të parcelës bujqësore, shfrytëzimi aktual arë klasë 3, në vendin e quajtur ‘P.....’ me sipërfaqe të përgjithshme prej 1.....metra katror, pjesa e pronës 1/1, më së largu deri me datën 05.01.2014 do t’ia paguaj shitësit Sh.L, shumën prej €.

Kontratën e Qirasë e lidhur me datë 08.11.2013, ndërmjet Sh.Lsi qiradhënës dhe R.G, Ambasada e Republikës Federale të Gjermanisë në Prishtinë si qiramarrës dhe nga e njëjta ka vërtetuar se Sh.Lsi qiradhënës ia ka lëshuar me qira qiramarrësit- Ambasadës së Gjermanisë në Prishtinë, shtëpinë e pa mobiluar rreth metra katror, e cila gjendet në lagjen Q.....p. n. në V....., Prishtinë, me të drejtë shfrytëzimi nga data 01.02.2014 deri më 30.06.2017, me qira mujore në shumë prej Euro.

Padinë ku si paditës është Sh.L dhe i paditur është I.S nga K..... Komuna D....., e bërë në Gjykatën Themelore në Prishtinë dhe nga e njëjta vërtetohet se Sh.L si paditës ka kërkuar që të aprovet padia e tij me të cilën ka kërkuar nga gjykata që ta obligoj të paditurin I.S nga K.....,

Komuna D....., që në afat prej 15 ditësh nga dita kur ky Aktgjykim merr formën e prerë, t' ia paguan paditësit borxhin në shumë prej Euro me kamatëvonesë vjetore prej 4.5% të llogaritur nga data 05.01.2014 e deri në ditën e pagesës së këtij borxhi.

Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë- Departamenti Civil, me numër C.nr..... i datës 07.07.2014 dhe ka nga i njëjti ka vërtetuar se kjo gjykatë me Aktvendim ka caktuar masën e sigurimit, ashtu që i ka ndaluar kundërshtarit të sigurimit I.S nga K..... e D....., që t' ia tjetërsojë, fshehtë, ngarkojë, apo zë disponojë me paluajtshmërinë e cila evidentohet në emër të kundër propozuesit I.S nga K..... e S..... si ngastër kadastrale P-....., Zona Kadastrale P.....në sipërfaqe prej metra katror në vendin e quajtur "P....." dhe njëherë ka detyruar të njëjtin që deri në përfundimin e këtij kontesti me vendim të formës së prerë, apo deri në një vendim tjetër të kësaj gjykate, që të mos marrë kurrfarë veprimesh në ngastrën kontestuese nën kërcënim të pasojave ligjore.

Pas vlerësimit të provave të lartcekura gjykata e shkallës së parë ka gjetur se i fillimisht kanë lidhur kontratën mbi shit-blerjen, shitës I.S, blerës i E.Ç, me datë 24 gusht 2012, parcelën e tokës nr. e ka blerë nga I.S në çmim prej€ (..... € për m2), ndërsa me datë 16 nëntor 2012, i pandehuri E.Ç, parcelën e tokës nr. në V..... e ka blerë nga i pandehuri Sh.L në çmim prej000 (..... € për m2), ku me datë 7 maj 2015, parcelën e tokës nr. në V....., e ka shitur tek të pandehurit J.L dhe A.H në çmim prej000 € (..... € për m2), ku i pandehuri E.Ç e ka bërë barjten e pronësisë mbi parcelat e lartcekura pa as një pengesë ligjore dhe konform dispozitave ligjore, po ashtu edhe të pandehurit Sh.L, J.L dhe A.H kanë bërë barjten e pronësive të parcelave të lartcekura pa as një pengesë ligjore dhe konformë dispozitave ligjore andaj vërtetohet se të njëjtit janë blerës me mirëbesim.

326. Kontrata për shitblerje të patundshmërisë, shitës Sh.M, blerës M.....B..... C..... kontratë për bartje Numri i librit inter përcjellës me datë 15.08.2012, Kontratë mbi shit- blerjen e patundshmërisë, e lidhur në Prishtinë, datë 29.06.2012, në mes të palëve kontraktuese Sh.M, (shitës) dhe "M.....B.....C....." SH.P.K të cilën e përfaqëson Drejtori S.B (blerës) e evidentuar sipas ngastrës kadastrale P-..... në vendin e quajtur "V....." shfrytëzimi aktual arë e klasës së 3, me sipërfaqe prej m² ZK P....., KK P..... (shitësi ia shet në vlerë prej000 € dhe Vërtetimi i Gjykatës Komunale në Prishtinë, Vr.nr., datë 02.07.2012.

Autorizimi ku autorizohet A.M, nga S.B "M.....B.....C....." SH.P.K dhe Vërtetimi i Gjykatës Komunale në Prishtinë, Vr.nr., Datë 02.07.2012; Fletë-pagesa e bankës datë 12.07.2012, M.....B....., Sh.M.

Shkresa e Qeverisë së Republikës së Kosovës- Ministria e Administratës Publike-Agjencia Kadastrale e Kosovës, Kërkesë për regjistrimin e paluajtshmërisë, datë 18.07.2012, nr. protokollit Zona Kadastrale Prishtinë, Komuna Prishtinë, parashtruesi i kërkesës “M.....B.....C.....” SH.P.K, pronar i mëparshëm Sh.M, të dhënat për parashtruesin e kërkesës si përfaqësues ligjor A.M, nr. njësisë P-MMMMMMMMMM, vendi i quajtur V....., lloji i kulturës arë e klasit, sipërfaqjam2.

Shkresa e Qeverisë së Republikës së Kosovës - Ministria e Administratës Publike, Agjencia Kadastrale e Kosovës, nr. lëndës - protokollit Zona Kadastrale P....., Komuna P..... formulari nr..... datë 30.07.2012, ku merret Aktvendim dhe Aprovohet Kërkesa e “M.....B.....C.....” SH.P.K, e cila ka të bëjë me bartjen nga parcela kadastrale nr. P....., Komuna P.....

Gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se Aktvendimin PN.nr..... i datës 29.10.2018, i marrë nga Gjykata e Apelit të Kosovës dhe nga i njëjti ka vërtetuar se kjo gjykatë ka refuzuar si të pabazuar ankesën e Prokurorit të PSRK-së në Prishtinë PPS.nr..... të datës 26.09.2018, e ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti i Krimeve të Rënda PKR.nr..... të datës 23.09.2018 ku është bërë hudhja e aktakuzës dhe është pushuar procedura kundër të akuzuarve A.V, B.Zh, D.B, J.G, Xh.K, I.A, A.M, L.Z, A.J, G.R, B.B, E.B, G.F, F.F, B.B, B.G dhe Sh.K për veprat penale për të cilat akuzohen sipas aktakuzës të Prokurorisë Speciale të EULEX-it , PPS.nr. të datës 03.03.2016, konform nenit 250 par.3 të KPPRK-së. Gjithashtu me të njëjtin vërtetohet se janë aprovuar ankesat e mbrojtësve të pandehurve G.A, av. Halit Ademi, N.H, av.Sadije Mjekiqi, R.F, av.Valon Hasani, ndërsa është anuluar aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Krime të Rënda PKR.nr. të datës 23.09.2018, ku është refuzuar kundërshtimi i provave dhe kërkesa për hudhjen e aktakuzës dhe çështja i është kthyer Gjykatës së njëjtë në rivendosje. Gjithashtu me të njëjtin vërtetohet se kjo gjykatë ka refuzuar si të pabazuara ankesat e mbrojtësve të akuzuarve M.P av.Tahir Recaj, D.E, av.Durim Osmani, A.M av.Ahmet Kasumi, Sh.M, av.Nora Veliu të ushtruara kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë- Departamenti për Krime të Rënda PKR.nr..... të datës 23.09.2018.

Është lexuar qarkullimi bankar i “M.....B.....C.....”, SH.P.K., për periudhën kohore 01.01.2009 deri me datë 12.11.2012 i lëshuar nga Banka.....B..... dhe nga i njëjti vërtetohet se ky biznes ka pasur qarkullim bankar në shumë prej Euro ndërsa Euro ka marrë kredi.

Pas vlerësimit të provave të lartcekura gjykata e shkallës së parë ka gjetur se i fillimisht kanë lidhur kontratën mbi shit-blerjen, Sh.M shitës dhe “M.....B.....C.....” SH.P.K të cilën e përfaqëson Drejtori S.B blerës, ka marrë certifikatën mbi pronësinë e parcelës të lartcekura, ku në bazë të provave të lartcekura biznesin e tij ‘M.....B.....C....., SH.P.K., për periudhën kohore 01.01.2009 deri me datë 12.11.2012 ka pas qarkullim të mjaftueshëm të parave për ta blerë parcelën në kohën e lidhje së kontratës me datë 2 korrik 2012, përmes përfaqësuesit të tij A.M parcelën e tokës nr. në V..... e ka blerë nga Sh.M në çmim prej,000 € (..... € për m2), si dhe pagesën për blerjen e parcelës e ka bërë përmes bankës, andaj nuk qëndron pretendimi i prokurorisë se nuk dihet prejardhja e parave që të pandehurit në këtë çështje penale që i kanë blerë parcelat, andaj në rrethanat e lartcekura i pandehuri S.....e ka bërë brejtën e pronësisë mbi parcelën pa as një pengesë ligjore dhe konform dispozitave ligjore, është vërtetuar se i njëjti nuk ka qenë në dijeni për historiatin e parcelës dhe ka qenë blerës me mirëbesim.

Kontrata mbi shit-blerjen e patundshmërisë, e lidhur në Prishtinë, datë 29.06.2007, në mes të K.B nga Ll..... shitës dhe blerësit Xh.B, nga fshati T..... Komuna P....., (shitësi ia shet pronën e regjistruar në fletë poseduese nr. ZK Ll....., si ngastër kadastrale nr....., në sipërfaqe prej ha, të cilën ia shet blerësit në çmimin e përgjithshëm prej €, e vërtetuar në Gjykatën Komunale Prishtinë, Vr.nr.....

Fletëpagesa e R..... Bank,, datë 03.07.2007, Xh.B, për Sh.S; Shkresa e Qeverisë së Republikës së Kosovës- Ministria e Administratës Publike-Agjencia Kadastrale e Kosovës, Kërkesë për regjistrimin e paluajtshmërisë, nr. protokollit, Zona Kadastrale Ll....., Komuna P....., Xh.B (parashtrues i kërkesës, pronarët e mëparshëm B.K.M; Shkresa Aktvendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës - Ministria e Shërbimeve Publike-Agjencia Kadastrale e Kosovës, nr. lëndës-protokollit, Zona Kadastrale LL. Selle, Komuna P....., formulari nr..... datë 12.07.2007, ku merret Aktvendim dhe Aprovohet Kërkesa e Xh.B, e cila ka të bëjë me bartje nga parcela kadastrale Nr. ZK LL. Selle, Komuna P.....; Kopja e Planit-Drejtorati për Kadastër dhe Gjeodezi, Komuna Kadastrale Ll..... Shk e zvog fletëposedimi nr..... plani nr..... pronari B.Xh, datë 20.02.2008.

Gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar edhe Kopjen e Planit e datës 20.02.2008, e lëshuar nga Komuna e Prishtinës, Drejtorati për Kadastër dhe Gjeodezi dhe nga e njëjta vërtetohet se ngastra kadastrale me numër, me kulturë bujqësore, në vendin F.....Gj....., ka ari e

..... metra katror dhe e njëjta gjendet Komunën Kadastrale në Ll....., me numër Fletëposedimime numër plani 10 dhe është në emër të pronarit B.Xh.

Certifikatën mbi të drejtat e pronës së paluajtshme me numër UL-..... e datës 20.02.2008 dhe nga e njëjta vërtetohet se pronar i vetëm i parcelës me numër të njësisë P-....., në sipërfaqe prejmetra katror dhe e cila gjendet në vendin Sh.P, në Zonën Kadastrale Ll...../ L.....S....., është Xh.B.

Kontrata mbi shit-blerjen e patundshmërisë, e lidhur në Prishtinë, datë 06.03.2008, në mes të Xh.B t si shitës dhe N.Sh si blerës, ku shitësi ia shet parcelën me numër P-, fletë posedimi nr....., në vendin e quajtur F.....Gj....., klasë tokë bujqësore, në sipërfaqe prejari e m2, KK Ll..... dhe Vërtetimi i Gjykatës Komunale në Prishtinë, Vr.nr....., datë 06.03.2008.

Në aktgjykim janë vlerësuar transaksionet bankare të datave 15.03.2000, 01.12.1999 dhe 26.11.1999 për Xh.B, pas vlerësimit të provave të lartcekura gjykata gjen se i fillimisht kanë lidhur kontratën mbi shit-blerjen, me datë 29 qershor 2007, parcelën e tokës nr., në L.....S..... nga shitësi Sh.S, i cili kishte vepruar në cilësi të përfaqësuesit dhe në emër të K.B, në çmim prej € (..... € për m2), tek blerësi i pandehuri Xh.B, i njëjti ka marrë certifikatën mbi pronësinë e parcelës të lartcekur pa as një pengesë ligjore dhe konform dispozitave ligjore, pagesën për blerjen e parcelës e ka bërë përmes bankës, si dhe duke i vlerësuar raportet e përgjimit në këtë çështje penale i pandehuri Xh.B nuk ka pasur kontakt as njëherë me shitësin e parcelës Sh.S, ndërsa i pandehuri Xh.B me datë 06.03.2008 parcelën e njëjtë ja shet të pandehurit N.Sh, andaj sipas gjykatës së shkallës së parë është vërtetuar se i njëjtit nuk ka qenë në dijeni për historiatin e parcelës dhe ka qenë blerës me mirëbesim.

318. Kontrata mbi shitblerje të paluajtshmërisë, N.Sh Kontratë për Bartje Numri i librit inter përcjellës, me datë 25.03.2008, Kontratë mbi shit-blerjen e patundshmërisë me datë 06.03.2008 Shitësi –Xh.B Blerësi- N.Sh, çertifikata mbi pronësinë, aktvendimet me datë 14.03.2008.

Shkresa e Qeverisë së Republikës së Kosovës- Ministria e Administratës Publike-Agjencia Kadastrale e Kosovës, Kërkesë për regjistrimin e paluajtshmërisë, nr. protokollit, Zona Kadastrale Ll....., Komuna P....., Sh.N (parashtrues i kërkesës, pronar i mëparshëm B.Xh.

Shkresa Aktvendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës - Ministria e Shërbimeve Publike-Agjencia Kadastrale e Kosovës, nr. lëndës-protokollit, Zona Kadastrale LL.Selle, Komuna

P....., formulari nr.....datë 24.03.2008, ku merret Aktvendim dhe Aprovohet Kërkesa e N.Sh, e cila ka të bëjë me bartje nga parcela kadastrale Nr. ZK LL. Selle, Komuna P.....

Pas vlerësimit të provave të lartcekura gjykata e shkallës së parë ka gjetur se i fillimisht kanë lidhur kontratën mbi shit-blerjen, me datë 8 mars 2008, parcelën e tokës nr., në L.....S..... i pandehuri N.Sh e ka blerë nga i pandehuri Xh.B në çmim prej € (.....€ për m2), i njëjti ka marrë certifikatën mbi pronësinë e parcelës të lartcekur pa as një pengesë ligjore dhe konform dispozitave ligjore, me lartë nga ana e gjykatës u vlerësuar se i pandehuri Xh.B nuk ka qenë në dijeni për historiatin e parcelës dhe ka qenë blerës me mirëbesim, ndërsa i pandehuri Sh.N është vërtetuar se ka blerë parcele e lartcekur nga i pandehuri Xh.B, konform procedurave ligjore pas as një pengesë dhe i njëjtit nuk ka qenë në dijeni për historiatin e parcelës dhe është blerës me mirëbesim.

339. Kontratë për shitblerje të patundshmërisë, shitës K.B blerës M.K Kontratë për Bartje Numri i librit inter përcjellë me datë 10.12.2007, Kontratë mbi shit-blerjen e patundshmërisë me datë 11.09.2007, shitësi K.B blerës M.K, çertifikata mbi pronësinë, aktvendimet me data 08.11.2007 pagesa nga banka.

Kontrata mbi shit-blerjen e patundshmërisë, e lidhur në P....., datë 11.09.2007, në mes të K.B (shitës) dhe M.K (blerës) shitës ia shet paluajtshmërinë e cila është e regjistruar në fletë poseduesen nr. UL..... ZK Ll....., si ngastër kadastrale nr., në sipërfaqe prej ha, në çmimin e përgjithshëm prej €, dhe Vërtetimi i Gjykatës Komunale në Prishtinë, Vr.nr....., datë 14.09.2007.

Shkresa e Qeverisë së Republikës së Kosovës- Ministria e Shërbimeve Publike-Agjencia Kadastrale e Kosovës, Kërkesë për regjistrimin e paluajtshmërisë, dt.22.10.2007, nr. protokollit, Zona Kadastrale Ll....., Komuna P....., K.M, parashtrues i kërkesës, pronar i mëparshëm B.K.M); Fletëpagesa e R..... Bank,, datë 25.10.2007, Sh.S, M.K; Fletëpagesa e R.....Bank,, datë 29.10.2007, Sh.S, M.K; Fletëpagesa e R..... Bank,, datë 30.10.2007, Sh.S, M.K.

Shkresa Aktvendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës - Ministria e Shërbimeve Publike-Agjencia Kadastrale e Kosovës, nr. lëndës-protokollit, Zona Kadastrale LL. Selle, Komuna P....., formulari nr..... dt.08.11.2007, ku merret Aktvendim dhe Aprovohet Kërkesa e M.Kt e cila ka të bëjë me bartje nga parcela kadastrale Nr.ZK LL. Selle, Komuna P.....

Shkresa e R..... Bank, dt.15.01.2013, drejtuar Gjykatës Themelore në Prishtinë-Zyra për verifikimin e kontratave, lënda: Dhënia e pëlqimit për bartjen e pronësisë së parcelës nr. P- Certifikata mbi të drejtat e pronësisë nr. UL-..... (lidhur me vërtetimin e kontratës dhe ndërrimin e pronarit për parcelat P..... me sipërfaqe prejm2 e cila është e evidentuar në Certifikatën mbi të drejtën e pronës së paluajtshme UL- ZK Ll....., G..... nga M.K tek Is NPT “J.M” dhe se nuk mund të përdorët për asnjë qëllim tjetër.

Certifikata mbi të drejtat e pronës së paluajtshme, e Agjencisë Kadastrale të Kosovës, Zyra Kadastrale G....., nr. certifikatës UL-....., data dhe koha e lëshimit 1.16.2013, ora 12:10:17 PM, Komuna G....., Zona Kadastrale Ll....., posedues K.M nr. ID vendbanimi fshatin B....., pjesë e pronës 1/1, azhurnuar nr. i njësisë, lloji i pronës parcelë, Zona Rural, shfrytëzimi aktual bujqësore, vendi i quajtur Sh.P, sipërfaqja, azhurnuar hipoteka, dokumentet e hipotekës, Ov.br....., dt.20.03.2012, shuma e borxhit,000 €, data e kthimit 3/20/2014, prioritet 1, azhurnuar, afati dhe kushtet 24 muaj, parcela br....., debitori J.M, Nr. ID vendbanimi P.... Rruga, peng dhënësi K.M Nr. ID vendbanimi fshati B....., peng marrësi Nr. ID, Vendbanimi P....., Rruga “.....”, nr.....

Kontrata mbi shit-blerjen e patundshmërisë, e lidhur në P....., datë 16.01.2013, në mes të M.K si shitës dhe N.P.T “J.M” si blerës shitësi ia shet paluajtshmërinë e cila gjendet në Ll....., e cila është e regjistruar në fletë poseduesen nr. UL- dhe regjistruar sipas ngasës P-....., në vendin e quajtur “Sh.P” me kulturë bujqësore dhe me sipërfaqe totale prej m2, ZK Ll.....KK G..... në shumë prej000 € dhe Vërtetimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Vr.nr.....2013, datë 17.01.2013.

Autorizimi i Ç.J, përfaqësues ligjor “J.M” për A.M dhe vërtetimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Vr.nr....., datë 17.01.2013; Fletëpagesa e R.....Bank,, datë 21.03.201, J.M dhe M.K; Fletëpagesa e R..... Bank,, datë 27.02.2012, J.M M.J dhe M.K.

Shkresa e Qeverisë së Republikës së Kosovës- Ministria e Administratës Publike-Agjencia Kadastrale e Kosovës, Kërkesë për regjistrimin e paluajtshmërisë, Komuna G....., Zona Kadastrale Ll..... N.P.T “J.M” (parashtrues i kërkesës, pronarët e mëparshëm K.M), nr. njësisë vendi i quajtur Sh.P, lloji i kulturës arë, sipërfaqja m2, dt.17-01-2013, ora 9:59:56 AM, datë 22.01.2013, pas vlerësimit të provave të lartcekura gjykata gjen se i fillimisht kanë lidhur kontratën mbi shit-blerjen, me datë 11 shtator 2007, parcelën e tokës nr. në L.....S..... nga shitësi Sh.S, i cili kishte vepruar në cilësi të përfaqësuesit dhe në emër të K.B,

në çmim prej € (..... € për m2), tek blerësi i pandehuri M.K, i njëjti ka marrë certifikatën mbi pronësinë e parcelës të lartcekur pa as një pengesë ligjore dhe konform dispozitave ligjore.

Sipas gjykatës së shkallës së parë duke i vlerësuar raportet e përgjimit në këtë çështje penale i pandehuri M.K nuk ka pasur kontakt as njëherë me shitësin e parcelës Sh.S, pagesën për parcelë e ka bërë përmes bankës në emër të shitësi Sh.S, ndërsa me datë 16 mars 2013 i pandehuri M.K parcelën e tokës nr., në L.....S..... e ka shitur tek Ndërmarrja “J.M” në çmim prej000 € (..... € për m2), andaj është vërtetuar se i njëjtit nuk ka qenë në dijeni për historiatin e parcelës dhe ka qenë blerës me mirëbesim.

Dëshmitarja G.S në shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se bashkëshorti i ka vdekur në vitin 1991, e tokën e ka bartë mbi vete para vdekjes, nuk e di ku ndodhet toka, në mes të fshatit Ll.ë - Ç..... nuk e di sigurt, vëllai i tij e ka bartë tërë përgjegjësinë në lidhje me këtë pronë, dhe ka tentuar ta kthej krejt pasurinë dhe ka mundur ta kthej vetëm një pjesë, me siguri me vendim të gjykatës se nuk kam qenë e njoftuar, ne jemi vetëm si trashëgimtar, prona nuk është e bartur në emër timin dhe as të vajzës time por në emër të V..... (kumatit) është bartur, një arë e ka shit, nuk e di nuk më kujtohet kujt ja ka shit, ka qenë 9 ari, në vlerë prej000 euro, paret ia ka dhënë vjehrrës e cila ka jetuar me mua, por këto janë mjete të përbashkëta, për shkak se kjo ka qenë tokë e kthyer në emrin tonë, por nuk është kthyer toka jonë por një tokë tjetër që është ndërruar ashtu ka thënë V..... sa ka qenë gjallë, është kthyer nga N..... nga Ç....., *me pas ka deklaruar se më kujtohet deklarata e dhen me datë 19.06.2014, në lidhje me shitjen e një toke dhe qëndrojt pranë saj.* Deklarata në Policin e Eulex-it me datë 19.06.2014 ka theksuar se pasi që ka humbur djalin dhe bashkëshorti në një aksident në vitin 1993 jeton vetëm më vajzën e saj J..... S... në L.....S....., ndërsa që N..... S... e cila ka vdekur në vitin 2009 ka qenë nëna e bashkëshortit të saj, ndërkaq që G..... S... që ka vdekur para 5-6 viteve dhe V.... S... janë vëllezërit e bashkëshortit të saj. Më tutje ka shtuar se para luftës në vitin 1993 atyre si familje i është kthyer tokë, sa i është kujtuar 3 parcela, përmes një procedure në P..... dhe pastaj është zhvilluar procedura e trashëgimisë për kryerjen e të cilës është autorizuar V....., mirëpo nuk ka qenë në dijeni nëse është marrur ndonjë vendim lidhur me këtë procedurë, mirëpo që autorizimet janë bërë në Gjykatën e G..... dhe me tutje vetëm ai ka qenë i përfshirë në gjithë procedurën e trajtimit të tokave të kthyer, njëra nga 3 parcelat është shitur në shumë prej000 euro dhe kjo shumë është ndarë në 3 pjesë, ndërsa që një parcelë tjetër është shitur nga një avokat në shumë prej000 euro, i cili ka qenë i angazhuar në këtë çështje nga V..... dhe se shuma që ju ka takuar nga kjo shitje dëshmitares i është dhënë në kesh.

Pastaj, dëshmitarja është ballafaquar me rrethanat në vazhdim siç janë, *aktgjykimi P.Br..... në të cilin thuhet se parcelat e kthyer tek familja S... janë,,, ndërsa që parcelat dhe janë kompenzuar financiarisht, aktgjykimi tjetër me të njëjtin numër, ku konstatohet se janë kthyer përveç parcelave të lartcekura edhe parcelat,,,, dhe përkatësisht numri i parcelave të kthyer është 17; se në dosjen e gjykatës numër Vr.Br..... ekziston një autorizim i nënshkruar nga dëshmitarja N., V., G. dhe J., i vërtetuar në Gjykatën-dega në G..... me të cilën është autorizuar M.Spër të i ndërmarr të gjitha veprimet lidhur me aktgjykimin P.Br.....; autorizimi për E.G i nënshkruar nga dëshmitarja N., V., G., dhe J., i vërtetuar në Gjykatën-dega në G....., lidhur me parcelat dhe, e pastaj të njëjtin e ka transferuar tek Sh.S, e cili pastaj këto parcela i ka shitur tek A.V parcela në çmim prej000 euro dhe tek R.B parcelën në shumë prej000 euro dhe se po ashtu i njëjti i ka shitur A.V parcelat në sipërfaqem¹,,,, të gjitha këto në sipërfaqe totale prej m², në shumë prej000.00 euro, mirëpo që për të gjitha këto rrethana ka shprehur habinë e saj me gjithë këto parcela të konstatuar si të kthyer për familjen e saj, e po ashtu pamundësinë për të kujtuar se ka qenë në gjykatën e Prishtinës-Dega në Gr..... për të dhënë ndonjë autorizim ndonjë personi, të përmendur si më lart.*

Dëshmitarja J.S, në shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se më kujtohet se deklarata kamë dhënë në lidhje me një parcelë të cilën e kishte shitur nga xhaxhai imë V....., më kujtohet që gjyshja më ka thënë se edhe më herët ka filluar procedura e kthimit të një are të cilën procedurë e ka vazhduar xhaxhai im dhe se në duhet t'ia japin autorizimet, edhe gjyshja na ka thënë por edhe xhaxhai e ka kërkuar autorizimin nga ne, *unë kam qenë fëmijë pa baba dhe kam jetuar me nënën dhe gjyshen dhe unë si trashëgimtarë e babait me plot besim ja kam dhënë autorizimin xhaxhait tim V....., unë nuk e di ku është ajo parcelë, është shitur një por nuk e di cila, xhaxhai i ka ndarë ato para në tri pjesë, unë ato para nuk i kam parë, por kam dëgjuar se gjyshes sime ja ka dhënë000 euro, në dy herë kemi qenë me dhënë autorizime, nuk më kujtohet a ka pas aty avokat, kemi qenë me xhaxhain dhe ne ju kemi dhënë autorizimin xhaxhait në Gjykatën e G.....s, më kujtohet deklarata e dhen me datë 24.06.2014 dhe qëndroj pran saj. Në deklarata e dhënë në Policin e Eulex-it me datë 24.06.2014, pranë të cilës deklarata ka theksuar se mbetet në tërësi, ka pohuar se G..... është nëna e saj, N..... gjyshja nga ana e babait e cila ka vdekur ne vitin 2008, ndërsa që G..... ka vdekur 2006 dhe V..... axhallart e saj. Më tutje ka theksuar se sa e mban mend paraluftës babai i saj ka kthyer disa toka, dhe atë toka ku jeton nëna e saj, parcela-toka afër shtëpisë si dhe një parcel-tokë të cilën e kanë shitur me vonë dhe pastaj pas luftës axha*

V..... ka kthyer disa të tjera, mirëpo që për numrin dhe të dhëna tjera lidhur me këto parcela nuk ka pasur njohuri, përveç që lidhur me këtë dëshmitarja, nëna e saj G....., axha G..... dhe gjyshja N..... në degën e gjykatës në G..... i kanë dhënë autorizimin V..... për të vepruar në emër të tyre dhe se në këtë drejtim ai ka shitur një parcelë dhe nga parat nga shitja e kësaj parcela janë ndar në 3 pjesë në shumë prej000 euro. *Pastaj, dëshmitarja është ballafaquar me aktgjykimi P.Br..... në të cilin thuhet se parcelat e kthyer tek familja S... janë,,, ndërsa që parcelat,, dhe janë kompenzuar financiarisht, aktgjykimi tjetër me të njëjtin numër, ku konstatohet se janë kthyer përveç parcelave të lartcekura edhe parcelat,,,,, dhe përkatësisht numri i parcelave të kthyer është 17, për çka ka deklaruar me habi lidhur me numrin e parcelave, për të cilat ka thënë se nuk ka njohuri për të njëjtat, mirëpo që ka qenë njëherë në Gjykata, ku së bashku me nëna e saj G....., axha G..... dhe gjyshja N..... i kanë dhënë një autorizim një avokati për përfaqësim, emrin e avokatit nuk e ka ditur pasi që për këtë është kujdesur axha V..... dhe se nuk është e sigurt se a ka shkuar njëherë apo dy herë në gjykatë për të dhënë autorizim dhe pastaj është ballafaquar me autorizimin i nënshkruar nga dëshmitarja, nëna e saj G., N., V. dhe G., i vërtetuar në Gjykatën-dega në G., me të cilën është autorizuar M.Spër të i ndërmarr të gjitha veprimet lidhur me aktgjykimin P.Br....., si dhe autorizimin për E.G i nënshkruar nga dëshmitarja, nëna e saj G., N., V. dhe G., i vërtetuar në Gjykatën-dega në G., lidhur me parcelat dhe, për të cilët është përgjigjur se në autorizim është nënshkrimi i saj, edhe pse nuk është emri i saj i plotë dhe nuk i kujtohet kjo rrethana.*

Më tutje ka mohuar se ka qenë në dijeni që Sh.Sduke vepruar edhe në emër të saj ka nënshkruar kontratë për shitjen e ndonjë parcele me blerësit A.V, R.B, apo në çfarëdo rrethane që dëshmitarja nëna e saj G., N., V. dhe G., ta kenë autorizuar E.G për shitjen e parcelave,,, dhe që ndodhen në C....., parcelën e tokës në sipërfaqe prej ha, që ndodhet në si dhe parcelat, dheqë gjenden në L.....S..... dhe në këtë drejtim ka theksuar se është hera e parë që po dëgjon se familja e saj ka pasur parcela në Ç..... apo P....., ani pse lidhur me Ç..... nuk ka qenë e sigurt pasi që lidhur me një parcelë në Ç..... kanë marrur një pronë dikun tjetër dhe se po ashtu gjatë prezantimit të këtyre autorizimeve, ka theksuar se germa "C" në nënshkrim, nuk është e tillë siç e shkruan dëshmitarja.

Dëshmitari M.S, në shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se gjatë viti 2006 kamë ushtruar profesionin e avokatit, ashtu siç kam deklaruar gjatë marrjes në pyetje në Prokurori, në asnjë rast nuk kam qenë i implikuar në këtë rast, nuk më kujtohet që ma kam marr ndonjë veprimi juridik çoftë si

avokat apo në emër të familjes Steviç apo kujtdo çoftë tjetër, nuk e njoh askënd prej familjes S....., nuk kam pas kurrfarë kontakti apo bisedë me asnjë prej personave këtu të akuzuar apo edhe të akuzuarit në rastin tjetër që është duke u udhëhequr pranë kësaj gjykate, *jam në dijeni për autorizimi më është prezantuar dhe për herë në emër të familjes S....., e kam parë kur jam marr në pyetje në Prokurori*, ai autorizim asnjëherë nuk është përpiluar nga unë pasi që ai autorizim përmban disa gabime dhe unë nuk kam lejuar asnjëherë që autorizime të tilla të dalin nga zyra ime, më vjen keq që është keqpërdorur emri im, nuk kam pas asgjë të bëj më rastin aq më tepër e kam ndier veten keq kur jam intervistuar si i dyshuar, si dhe asnjëherë nuk ka paraqitur kërkesë pranë zyrën kadastrave për përmbartimin të aktgjykimi në regjistrat kadastral. Ka shtuar se jam i informuar edhe lidhur me këtë kërkesë edhe atë për herë të parë kur jam marr në pyetje në prokurori, me përgjegjësi të plot morale, materiale dhe penale deklaroj se një kërkesë e tillë nuk është përpiluar nga unë dhe jam shumë i bindur se nënshkrimi im në atë kërkesë nuk qëndron por e ka nënshkruar dikush tjetër, sikur të kisha bërë kërkesë në kadastrë apo kudo qoftë tjetër unë kisha me shku edhe me u interesu lidhur me kërkesën, nuk ka asnjë dëshmitar që mund ta konfirmoj se unë kam qenë në Drejtorinë e Kadastrit ndonjëherë lidhur me këtë rast.

Dëshmitari M.J në seancën e shqyrtimit gjyqësor ka sqaruar se që nga viti 2012 jam pronar parcelës me numër në sipërfaqe prejm², me lokacion në Ll.ë të cilën e kam blerë në mënyrë ligjore, pranë avokatit të shitësit A.Mndërsa shitësi ka qenë M.K, në momentin kur kam rënë dakord me çmim, unë personalisht kam kërkuar që lënda të dërgohet tek avokati B.B, pastaj shitësi më ka thënë se të gjithë dokumentacionin e kemi tek avokati jonë A.Mi cili është i njoftuar me lënda, unë kam pranuar dhe kemi shkuar tek zyerja e tij tek S.....S....., i cili është drejtuar në mënyrë njerëzore, dhe nuk kam pasur asnjë vërejtje ndaj avokatit, i kemi zbatuar të gjitha procedurat ligjore, avokati ka lidhur marrëveshjen time me shitësin, ka përshkruar marrëveshjen, pasi janë përfunduar pagesat, marrëveshjen numër 2 e ka bërë po i njëjti avokat, dhe të gjithë dokumentacionin së bashku me avokatin dhe shitësin jemi drejtuar në Gjykatën Themelore në Prishtinë e kemi vërtetuar pronësinë, sot e posedoj të njëjtë pronë, shqetësime nuk kam pasur nga asnjë person, të gjitha janë bërë me vullnet të dy palëve, me kontratë, pagesa është bërë përmes bankës, *vlera e pronës ka qenë më e lartë se në treg, dikun 30% mbi vlerë të tregut, unë nuk e akuzoj shitësin sepse unë vet e kam pranuar çmimin e ofruar, me vullnetin time kam nënshkruar kontratën*, pasi që në vitin 2012, unë udhëtoj shpesh nëpër P..... afër parcelës ka qenë tabela “toka në shitje”, ka qenë numri i personit kontaktues, kam biseduar në telefon me të, më është lajmëruar A.K është djali i M.K, takimi i parë me të ka qenë në “H.....P.....” në “E.....”, takimi atë ditë ka qenë pas dy dite së bashku unë, M..... dhe djalin e tij A.K, në

kafiterinë përballë “B.....D.....” në D..... aty kemi lidh marrëveshjen në vlerë financiare000, dhe mëryen e pagesave e kemi caktuar në këto kushte: fillimisht ditën e marrëveshjes ia kam dhuruar veturën “.....”, në vlerë prej000 euro si dhe po të njëjtën datë i kam bërë pagesëeuro në bankë, ndërsa pagesa numër 2 është bërë me datë 21.03.2012 në vlerë prej000 euro nga llogaria bankare, dhe pagesa 3 është bërë me datë 31.08.2012 në vlerë prej000 euro nga llogaria e njëjtë dhe është përmbushur vlera marrëveshjes në vlerë000 euro, të gjitha dokumentet i kam parë, si lista poseduese, kopja e planit, në emër të M.K, të vërtetuara nga Zyra Kadastrale në Prishtinë, dhe nuk kam pas aspak dyshim që do të ndodh kjo situatë që për mua dhe familjen time e palakueshme dhe e papranueshme që 10 vite te merremi me gjykatën, më pas ka theksuar se për të dy pagesat e lartcekura kam marr kredi nga banka ime R.....Bank, fillimisht marrëveshja është lidhur në mes meje M.J dhe M.K në vitin 2012, pastaj pasi pagesat i kam kryer nga llogaria bankare e firmës të cilën e posedoj e kemi ripërtërirë të njëjtën marrëveshje në mes meje M.J dhe M.K, për 36 muaj pronën të cilën e kam blerë nga M.K ka qenë nën hipotekë në të njëjtën bankë derisa i kam shlyer të gjitha detyrimet ndaj bankë, pasi i kam shlyer detyrimet, ju kam drejtuar bankës dhe e kam liruar nga hipoteka, kjo ka ndodh 3 vite pas blerjes në vitin 2015, ndërsa nuk më ka interesuar fare kush ka qenë pronar i më hershem i parcelës sepse nuk jam as hetues, as prokuror, unë pagesën e kam kryer në mënyrë të rregullt.

Nuk ka qenë kompetencë e tij që të vërtetoj pronësinë e mëhershme, kur unë kam vendosur me ble këtë pronë dhe me pas një pike shitëse të materialeve ndërtimore edhe në Prishtinë, kjo ka qenë arsyeja pse kam marr kredia dhe kam dhënë veturë për zgjerimin e kapaciteteve ekzistuese të cilat i kam, pasi që në intervistimin e parë që e kam pasur në Eulex e kam pasur edhe planin për zhvillimin dhe investimit me vlerë mbi000.000, në po të njëjtën parcelë dhe prokurori i cili më ka intervistuar më ka thënë që prona jote është blerë ligjore, dhe i gjithë dokumentacioni që e posedoj është në mënyrë ligjore dhe ai më ka ndalu për të investuar për një periudhë kohore të pacaktuar deri në zgjedhjen e pronësisë, e që mua më ka shkaktuar një dëm të konsiderueshëm financiar po ashtu edhe në planin nga ana zhvillimore, nuk mundem të etiketoj ndonjë person të jam i dëmtuar nga ai, ky është proces zingjiror që na ka pru deri te kjo çështje e pa lakmueshme për të gjithë ne, kur unë kam vendos me ble i gjitha dokumentacioni ka qenë i rregullt dhe nuk kam pasur asnjë vërtetje as nga shitësi ajo ka qenë çështje e imja.

Më tej ka deklaruar se qëndron pas deklaratës së dhënë në në Policinë e EULEX-it me datë 01.06.2016, sikurse edhe në dëshminë e dhënë gjatë shqyrtimit gjyqësor, se paluajtshme rin në sipërfaqe prejm2, në L.....S..... e ka blerës nga M.K dhe djem e tij me të cilët edhe

ka zhvilluar kontaktet dhe është takuar pasi që kishte marrur numrin nga njoftim për shitje i cili ka qenë i vendosur në parcelë dhe pastaj kanë ren dakord për çmimin prej000 euro, ashtu që000 euro ja ka transferuar përmes bankës ndërsa që në emër të shumes tjetër të mbetur ja ka kompenzuar me një veturë dhe se kontratën e kanë përpiluar tek avokati A.Msiç është sugjeruar nga A..... dhe M.K.

Më tutje, dëshmitari ka deklaruar se ka bërë verifikimin e dokumentacionit dhe ka vërtetuar se i njëjti është në emër të shitësit M.K dhe se nuk ka qenë fare në dijeni se kush ka qenë pronar i më pashëm i asaj toke, mirëpo që sa i përket çmimit të blerjes ka theksuar se *pasi që ka blerë parcelën ka kontaktuar me pronaret e parcelave të cilët kanë qenë në fqinjësi me parcelën e tij dhe nga të njëjtit ka kuptuar se çmimi varionte nga000 deri000 euro për ari dhe se vetë dëshmitari e ka paguar çmimin prej euro për ari.*

Kolegji trajtoj edhe deklaratimet e dëshmitarëve N.H, B.K, V.N, V., D.L, S.K, R.B, F.M, H.C, F.R, N.A, deklaratat e dëshmitareve të dhëna në policin e Eulex-it; J.M, Sh.S, deklaratat e dëshmitareve N.B dhe F.P të dhënë gjatë mundësisë hetues të veçantë, deklaratat e dëshmitareve Zh.V, B.V, dhe S.M, M.M, S.R.S të dhëna përmes ndihmës juridike nderkombëtare dhe B.S, mirëpo nga këto deklaratime nuk është vërtetuar asnjë fakt relevant lidhur me çështjen e cila është objekt gjykimi.

Ndërsa të gjithë të akuzuarit kanë shpjeguar mënyrën se si kanë ardhur deri të blerja e paljutmërive, të cilat kanë qenë objekt gjykimi në këtë çështje penale, ndër të tjera kanë deklaruar se bartja e të drejtave pronësore mbi këto palujtshmëri është bërë konform dipozitave ligjore, për këto palujtshemri kanë lidhur kontrata formale në formë të shkruar, të noterizuara, të dëshmuara me transaksione bankare përkatësisht transferimit të mjeteve financiare përmes xhirollogarive bankare dhe se nuk kanë pas asnjë ndalesë apo pengesë ligjore për shitblerjen e këtyre pronave.

Vështuar nga aspekti juridik, kjo vepër penale ekziston kur: kushdo që, duke e ditur ose ka arsye për të ditur se pasuria e caktuar buron nga ndonjë formë e aktivitetit kriminal, pasuri kjo e cila në të vërtetë fitohet me vepër penale, apo kushdo që duke besuar se pasuria e caktuar fitohet nga ndonjë formë e aktivitetit kriminal:

1.1. konverton, transferon ose përpiket të konvertoj ose të transferojë pasurinë me qëllim të fshehjes apo të maskimit të natyrës, burimit, vendit, dispozicionit, lëvizjes ose pronësisë së pasurisë;

1.2. konverton, transferon ose përpiqet të konvertojë ose të transferojë pasurinë me qëllim të ndihmës së personit i cili është i përfshirë në të ose që, siç pandehet, është i përfshirë në kryerjen e veprës penale që ka shkaktuar shmangien e pasojave ligjore apo të pasojave të qarta ligjore të veprimeve të tij.

1.3. konverton, transferon ose përpiqet të konvertojë ose të transferojë pasurinë me qëllim të nxitjes së aktivitetit të ndërlidhur kriminal;

1.4. merr, posedon, shfrytëzon apo tenton të merr, posedojë apo shfrytëzojë pasurinë;

1.5. fsheh ose maskon natyrën e vërtetë, burimin, vendndodhjen, sistemimin, lëvizjen, të drejtat në lidhje me, apo pronësinë e pasurisë, ose nga një akt i pjesëmarrjes në veprimtari të tilla;

1.6. merr pjesë në, bashkëpunon dhe ndihmon për të kryer, nxit, lehtëson dhe këshillon në kryerjen e ndonjë prej veprimeve të përmendura në nën-paragrafët 1.1 deri në 1.5. të këtij paragrafi.

Në referim të kësaj vepre penale Kolegji pajtohet me arsyet nga gjykata e shkallës së parë se përveç përshkrimit faktik të dispozitivit, nga provat e administruara nuk janë përmbushur ndonjë element i kësaj vepre penale, pasi që për të ekzistuar kjo vepër penale është e nevojshme të akuzuarit nga B.A deri te i akuzuari A.H të kenë ditur se pasuria e caktuar është fituar me vepër penale, ose buron nga ndonjë formë e aktivitetit kriminal, meqenëse në rastin konkret nuk ekziston ndonjë provë që do të konstatonte se blerësit e këtyre paluajtshmërive tani të akuzuarit të kenë pasur lidhje subjektive me të akuzuarit e pjesës tjetër të aktakuzës të njohur si “T....”, përmes të cilave prova do të rezultonte dyshimi eventual i bazuar, se këta të akuzuar kanë ditur, apo kanë mund të ishin në dijeni, se vendimi gjyqësor, regjistri kadastral e fletët poseduese nga të akuzuarit në çështjen penale T..., si S.s, F.G, E.G, Sh.M, E.U, I.S, ishin siguruar në mënyrë të kundërligjshme për kryerjen e aktiviteteve kriminale, si dhe në mungesë të fakteve për ekzistimin e marrëveshjes paraprake për pastrimin e parave, andaj pa prezencën e këtyre fakteve esenciale nuk plotësohen tiparet e veprës penale për të cilën janë akuzuar të akuzuarit.

Gjithashtu sa i përket çmimit të blerjes se paljutshmërive, Kolegji gjen se gjykata e shkallës së parë pas shqyrtimit të shkresave të lëndës ka konstatuar faktin se gjatë zhvillimit të procedurës hetimore, Drejtoria e hetimeve për krime ekonomike nga Policia e Kosovës, me datë 17.03.2015, i është drejtuar me një kërkesë Zyrës së Drejtorisë së Kadastrit në Prishtinë, nga e cila ka kërkuar që kësaj Drejtorie t’i dorëzohen kopjet e kontratave të shitblerjes së paluajtshmërive për regjionin e Qagllavicës, dhe atë vendi i quajtur M., M. M.B, M.V.B, M.B, M.D.P, M.M, MP, K.dhe V....., për periudhën 2010-2014. Dhe Drejtoria për Kadastër, i është përgjigjur kërkesës së Policisë së Kosovës, duke ia bashkangjitur një numër të kontratave të cilat variojnë me çmime të ndryshme, dhe atë:

Kontratën e datës 27.12.2012, me nr. të certifikatës, me nr. të parcelës P....., në zonën kadastrale P....zonë rurale më sipërfaqe ha, është shitur me çmim prej000.00 euro, çka do të thotë se është paguar çmimi për ari dikund rretheuro, apo .uro për metër katror;

Kontratën e noterizuar e datës 28.04.2014, me nr. të certifikatës, me nr. të parcelës P-....., në Zonën Kadastrale P....tokë bujqësore klasa e 4-të, me sipërfaqe prej m2, është shitur me çmim prej00 euro, që do të thotë me çmim për ari më pak se00 euro për metër katror, euro për metër katror;

Kontratën e noterizuar e datës 29.08.2012, me nr. të certifikatës UL....., me nr. të parcelës P-....., po ashtu në Zonën Kadastrale në P....tokë bujqësore, me sipërfaqe prejmetra katrorë, është shitur me çmimin prej00 euro, pra më pak se00 euro për metër katror apo më pak euro për metër katror;

Kontratën e datës 05.12.2012, me nr. të certifikatës UL-....., me nr. të parcelës P-..... në Zonën Kadastrale D..... të komunës së G.....s, sipërfaqja prej ha është shitur në shumën00 euro, me një çmim prej rreth euro për ari për metër katror apo rreth euro për metër katror;

Kontratën e shitblerjes e datës 29.12.2009, me nr. të certifikatës UL....., me nr. të parcelës P-.....në zonën kadastrale në Q....., tokë bujqësore, paluajtshmëria me sipërfaqe prejmetra katror, është shitur me çmimin prej00 euro, që do të thotë diku rrethuro për ari, apoeuro për metër katror ;

Kontratën e datës 14.01.2013, me nr. të certifikatës UL-....., me nr. të parcelës P-....., në zonën kadastrale të G.....s, me sipërfaqe prejmetra katror, është shitur me çmimin prej00 euro, që i bie dikund rretheuro për ari, apoeuro për metër katror ;

- kontratën e datës 06.01.2010, me nr. të certifikatës UL-....., me nr. të parcelës P-....., në zonën kadastrale Q..... tokë bujqësore, me sipërfaqe prejmetra katror, është shitur me çmimin prej euro që do të thotë dikund rreth euro për ari, apoeuro për metër katror ;

Kontratën e cila nuk ka datë të përpilimit, që bëhet fjalë për paluajtshmërinë me nr. të certifikatës UL-....., me nr. të parcelës P-....., në zonën kadastrale të Q....., tokë bujqësore, klasa e 4-të, me sipërfaqe prejmetra katror, është shitur me çmimin prej euro, që i bie rretheuro për ari, apo me pak seeuro për metër katror.

Në referim të kontratave të lacekura, përfshirë këtu të dhënat si në aktakuzë, rezulton se tani të akuzuarit paluajtshmëritë që janë objekt akuze, i kanë blerë me një çmim më të lartë, se çmimi i shitblerjes së këtyre paluajtshmërive në këto kontrata.

Pasi që nga kontratat e shitblerjes së këtyre paluajtshmërive të prezantuara nga Drejtoria për Kadastër në Komunën e Prishtinës, vërtetohet fakti se në këto kontrata, kemi të bëjmë me zona përafërsisht të njëjta kadastrale, me periudha të përafërta kohore të shitblerjes, kur është bërë dhe shitblerja e paluajtshmërive që janë objekt i akuzës, dhe një pjesë bukur e madhe e kontratave të paluajtshmërive të prezentuara nga zyra e kadastrit, rezulton të jenë shitblerje me çmime më të ulëta a të përafërta, me çmimin që e kanë paguar të gjithë të pandehurit që akuzohen për blerjen e paluajtshmërive në aktakuzë, Pra, nga këto prova materiale, nuk vërtetohet fakti se çmimi i shitblerjes së këtyre paluajtshmërive që janë objekt akuze, paska qenë më i ultë se çmimi i tregut për atë periudhë kohore.

Pretendimet e prokurorit se gjykata në rastin e marrjes së aktgjykimit nuk ka vlerësuar drejtë gjendjen faktike, në rrethanat e çështjes rezulton se gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të drejtë, janë analizuar provat dhe pas analizimi të tyre në asnjë formë nuk është provuar përgjegjësia e të akuzuarve në drejtë të veprës penale.

Thëniet në ankesë se gjykata gabimisht i ka dhënë peshë pretendimeve të akuzuarve. Kolegji i çmoi se janë në kundërshtim me faktet dhe provat në këtë çështje penale, nga rrethanat e çështjes nuk derivojnë të provuara veprime kundërligjore të akuzuarve mbi bazën e së cilave do të formësoheshin elementet e veprës penale sipas aktakuzës.

Nga dëshmitë e lartcekura, rezulton se aktakuza nuk bazohet në prova të qëndrueshme, nga këto prova në asnjë rrethanë nuk mund të vërtetohet se të akuzuarit e kanë kryer veprën penale pastrimi i parave duke qenë në dijeni për mënyrën e fitimit të pronësisë nga të akuzuarve në rastin T..., pasi që në rastin konkret për këto paluajtshmëri janë lidhur kontrata formale, në formë të shkruar, të noterizuara, të dëshmuara për transaksionet bankare përkatësisht transferimit të mjeteve financiare përmes xhirollogarisë bankare, nuk ka pas asnjë ndalesë apo pengesë ligjore për shitblerjen e këtyre pronave.

Në vijim të kësaj, rezultojnë dëshmitë se këto paluajtshmëri kanë qenë të bartura tek pronarët, duke u bazuar në vendime gjyqësore që kanë pasur formën e prerë dhe në bazë të atyre vendimeve gjyqësore janë regjistruar paluajtshmëritë në regjistrat kadastral në komunat përkatëse, atëherë një gjendje e tillë e fakteve në asnjë mënyrë nuk mund të lenë vend për dyshim, se fitimi i të drejtës së pronësisë, është bërë në mënyrë të kundërligjshme, në të kundërtën, nëse do viheshin në dyshim çdo herë vendimet gjyqësore dhe regjistrat kadastral paraprakisht, do të vëhej në pikëpyetje edhe vet funksionimi i organeve shtetërore në përgjithësi dhe rendi juridik, duke mos e përjashtuar faktin se mund të ketë vendim të kundërligjshëm gjyqësor, por në rastin konkret, askush nga palët me interes juridik, nuk i ka kontestuar vendimet gjyqësore me mjete të rregullta juridike, vendimet janë bërë të formës së prerë, dhe nuk është vendosur asnjë masë e përkohshme për ndalimin e bartjes së të drejtës së pronësisë për këto paluajtshmëri.

Përkundër faktit që prokuroria pretendon se të akuzuarit, duke qenë se ishin përfshirë në shitblerjet e pronave, thjeshtë për të fshehur përfitimin e krimit, ku blerësit janë ose figura që janë të caktuar në mënyrë specifike për të vepruar, ose mashtrues, ata konsiderohen kryes të veprës penale të pastrimit parave, bazuar në rrethanat faktike, pretendimet e tilla nuk kanë

rezultuar së provuari se të akuzuarit kishin në dijeni për këtë rrethanë, dhe të kenë marrë ndonjë veprim inkriminues në drejtim të veprës penale pastrimi i parave, kjo për faktin se përveç provave të ofruara nga dëshmitë e dëshmitareve dhe provave materiale, të akuzuarit në mënyrë të qartë dhe bindëse kanë sqaruar mënyrën se si ka ardhur të blerja-bartja e se drejtës së pronësisë së palujtshmerive.

Kolegji vëren se përshkrimi faktik i veprimeve inkriminuese është identik për të gjithë të akuzuarit, nga përmbajtja mund të dekonstruktohet si në vijim:

- a) duke e ditur ose duke pasur arsye për ta ditur se parcelat e tokës në pronësi shoqërore të cekura më poshtë janë fitim i krijuar me aktivitete kriminale

Kolegji, vlerëson se Prokuroria duhet të provoj me prova konkrete dhe specifike për secilin të akuzuar, se të njëtit ishin në dijeni apo kishin arsye për të ditur se parcelat në pronësi shoqërore janë fituar me aktivitet kriminal, kjo çështje duhet të jetë një përfundim i cili do të derivoj nga faktet e konstatuara përmes provave dhe dëshmive, por jo të mbetet në nivel hipotetik.

- b) Posaçërisht se pronësia e këtyre pronave ishte transferuar zyrtarisht tek persona të etnitetit serb, por në fakt nën kontrollin dhe posedimin e grupit të organizuar kriminal të përshkruar si në pikat 1 të akuzës, si rezultat i veprimtarive kriminale të përshkruara në pikat nga 1 deri në

Kolegji vëren, se duhet të qartësohet me cilat prova, do të provohej se të akuzuarit ishin në dijeni në mënyrë të posaçme se prona fillimisht të jetë transferuar tek personat e etnitetit serb, nën kontrollin dhe posedimin e grupit kriminal, kjo çështje kërkon të provuarit e aspektit subjektiv për secilin të akuzuar, dhe nuk mund të trajtohet në kuadër të një narracioni të përgjithshëm.

- c) Në bashkëpunim me shitësin e parcelës së tokës, ai ka transferuar dhe ka tentuar të transferojë pronat me qëllim të fshehjes apo maskimit të natyrës, burimit, sistemimit, lëvizjes dhe pronësisë së pronave,

Kolegji ngrit çështjen, se cilat janë dëshmitë dhe provat se të akuzuarit nuk ishin blerës real, por ishin blerës fiktiv dhe se transaksioni i shitblerjes ishte kryer me qëllim të fshehjes apo maskimit të lëvizjes së pronësisë së këtyre pronave.

d) Apo në çfarëdo rrethanash, me qëllim të asistimit të të pandehurve të tjerë të cilët ishin të përfshirë apo kishin qëllimin e përfshirjes në kryerjen e veprës penale që ka shkaktuar shmangien nga pasojat juridike, ose pasojat e mundshme ligjore, për veprimet e tyre në veçanti

Në këtë aspekt, në cilat rrethana konkrete të akuzuarit vepruan me qëllim të insistimit të pandehurave tjerë, në çka konsiston ky aludim i përshkruar si një prej veprimeve inkriminuese në aktakuzë, rezulton të jetë parafrazim i dispozitës ligjore të përmbajtjes inkriminuese të veprës penale të pastrimit të parave, pasi që është i pa konkretizuar, i nivelit abstrakt dhe nuk mund të kuptohet se për cilat rrethana konkrete është fjala.

Pretendimet ankimore të prokurorisë (i cili kryesisht i referohet arsyetimi të aktgjykimit të shkallës së parë), se nga provat e paraqitura nga prokuroria dhe të administruara në shqyrtim gjyqësor, fillimisht grupi i organizuar kriminal ishte në gjendje që me veprime kriminale të merrte pronësinë e parcelave të tokës të regjistruar si pronë shoqërore e Republikës së Kosovës, përmes mjeteve dhe veprimeve kriminale. Më pas, grupi shiti tokat drejtpërdrejtë në njërin nga dy mënyrat. Së pari, grupi kreu shitjet e rrejtshme duke transferuar pronësinë e tokës tek anëtarët e grupit, ose, së dyti, anëtarët e grupit ua shitën tokën drejtpërdrejtë palëve të treta. Parcelat u transferuan disa herë në mënyrë që të maskonin/fshihnin origjinën e tyre kriminale. Shumë nga shitjet ishin thjeshtë shitje të rrejtshme ku blerësit nuk kishin kapacitete ekonomike për t'i blerë asetet dhe çmimi i shitjes ishte jashtëzakonisht nën vlerën e tregut dhe kjo konsiderohet shpërlarje e parave.

Kolegji i vlerëson si të paqëndrueshme, për arsye se gjykata e shkallës së parë pikërisht duke u mbështetur nga provat e lartcekura të administruara në shqyrtimin gjyqësor ka ardhur në përfundim të drejtë dhe ligjor se në veprimet e të akuzuarve nuk janë formësuar tiparet e veprës penale për të cilat janë akuzuar, për rrjedhojë nuk është vërtetuar dijenia, për aktivitetin kriminal për të akuzuarit me rastin T...., apo se ka ekzistuar ndonjë marrëveshje paraprake për pastrimin e parave, si dhe as dashja dhe motivi i qëllimit të fshehjes së prejardhjes së parave si element kyç i veprës penale pastrimi i parave siç ka pretenduar prokuroria.

Kolegji trajtoi edhe faktin se sipas ankesës së prokurorisë, aktgjykimi nuk është i arsyetuar mjaftueshëm, nuk përmban arsye për fakte e rëndësishme si tillë është në shkelje të dispozitave të procedurës penale të përmendura në ankesë.

Kolegji ndan pikëpamjen se në aktgjykimin e atakuar janë dhënë arsye të mjaftueshme me rastin e vlerësimit të provave të administruara, pas vlerësimit të tyre janë paraqitur edhe përfundimet të cilat janë të qarta, e logjike që rrjedhin natyrshëm nga materiali provues.

Në këtë linjë është e nevojshme të ceket se në aktgjykimin që është objekt shqyrtimi janë trajtuar pretendimet thelbësore të akuzës e palëve, trajtimi në nivel të tillë është i mjaftueshëm për të arritur standardin e një vendimi gjyqësor të arsyetuar. Arsyet e dhëna janë konsistente, të qarta, jo dykuptimshme, jo kontradiktore. Sidoqoftë, shtrirja e obligimit për arsyetim të vendimit duhet të analizohet në dritën e rrethanave konkrete. Ndonëse një gjykatë nuk është e detyruar të japë përgjigje të hollësishme për çdo argument të ngritur (Van de Hurk k. Vendeve të Ulëta, § 61), nga vendimi duhet të dalë qartë që janë prekur pikat thelbësore të ngritura në çështje (Boldea k. Rumanisë, § 30). Në rastin konkret, Kolegji arrin në përfundim se janë trajtuar dhe janë dhënë përgjigjet në pikat dhe çështjet thelbësore që kanë qenë objekt i shqyrtimit dhe vlerësimit në këtë çështje penale.

Kolegji, pajtohet me të gjeturat, vlerësimet dhe përfundimet e trupit gjykues që i bënë dëshmime dhe provave, njëkohësisht rikujton, se procedura ankimore sipas KPP-së mbështetet në parimin se është detyrë e trupit gjykues që të dëgjojë, vlerësojë dhe peshojë provat gjatë gjykimit. Kolegji rikujton se procesi gjyqësor në Gjykatën e Apelit nuk duhet konceptuar si një proces *de novo* lidhur me faktet, përveç kur zbatohet standardi qartë i gabuar. Nga Gjykata e Apelit, kërkohet që t'i jap trupit gjykues të gjykatës së faktit hapësirë të mjaftueshme për arritjen e gjetjeve, dhe nuk duhet ti hedh poshtë gjetjet e trupit gjykues, duke i zëvendësuar ato me të vetat, përveç nëse provat në të cilat janë bazuar, nuk do të ishin të pranueshme për asnjë gjykatë të arsyeshme të faktit, ose kur vlerësimi i tyre ka qenë “tërësisht i gabuar”¹

¹ Prosecutor v. Zlatko Aleksovski, Case No. IT-95-14/1-A, Judgement, 24 March 2000 (“the Aleksovski Appeals Judgement”), para. 63, Prosecutor v. Dusko Tadic (Appeal Judgement), IT-94-1-A, International Criminal Tribunal for the former Yugoslavia (ICTY), 15 July 1999, para. 64., R. A. dhe D. (Gjykata Supreme e Kosovës, AP-KZ 477/05 i datës 25 janar 2008, f.20 (versioni në gjuhën angleze). Ky qëndrim është përsëritur dhe është zhvilluar më tutje në lëndët tjera në veçanti në lëndën kundër V.C (Gjykata Supreme e Kosovës, AP. nr. 140/2011, f.8, i datës 16. 08.2011).

Në këtë linjë, arsyeja pse Gjykata e Apelit nuk do t'i kontestoj lehtësisht gjetjet e fakteve nga gjykata e shkallës së parë, është e njohur mirë, që trupi gjykues ka përparësinë e vëzhgimit të drejtpërdrejtë të dëshmive të dëshmitarëve, dhe për këtë arsye është më mirë i pozicionuar se Gjykata Apelit për të vlerësuar vërtetësinë dhe besueshmërinë e dëshmive².

Për rrjedhojë, Kolegji ndan këndvështrimin e njëjtë me atë të gjykatës së shkallës së parë të shprehura në aktgjykim, se nga provat e prezantuara gjatë shqyrtimit gjyqësor nuk është arritur të provohet ekzistimi i veprës penale dhe përgjegjësia penale e të akuzuarave bazuar në dëshmitë e dëshmitarëve, provave materiale si edhe deklarimeve të akuzuarve, nuk rezultojnë të provuara faktet dhe rrethanat relevante që përbëjnë tiparet e veprës penale pastrimi i parave sipas aktakuzës.

Të gjeturat për shkelje të ligjit penal

Prokurori ankimon aktgjykimin e Gjykatës së shkallës së parë edhe në raport me shkeljen e ligjit penal, duke pretenduar se gjykata, përveç dështimit që të vërtetojë faktet vendimtare që kanë të bëjnë me veprën penale për të cilën akuzohen të pandehurit, e njëjta nuk jep asnjë arsye të qëndrueshme se përse dispozitat ligjore të caktuara të ligjit penal, e që ishin ato të paraqitura në aktakuzën e prokurorisë, nuk ishin aplikuar ndaj të akuzuarve dhe veprave të tyre.

Pretendimet e ankimore të prokurorit janë të pabazuara dhe të paargumentuara, mbi bazën e vërtetimit të gjendjes së fakteve, gjykata e shkallës së parë drejtë ka aplikuar edhe ligjin penal kur të akuzuarit i ka liruar nga akuza për shkak se nuk është vërtetuar se të njëjtit e kanë kryer veprën penale pastrimi i parave pasi që qartazi nga provat e administruara nuk kanë rezultuar si të provuara tiparet e kësaj vepre penale, që kanë qenë të përshkruara si veprime inkriminuese në dispozitiv që do të përbënin figurën e veprës penale për të cilën janë akuzuar.

Vepra penale e pastrimit të parave nni 56 par.1 i Ligjit mbi Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit e Terrorizmit, dispozita ekuivalente me nenin 10 (2) të Rregullores së UNMIK-ut, nr. 2004/2 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe veprave penale të përafërta“, po ashtu dispozita e nenit 32 të ligjit nr. 03/L-196 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit” në fuqi prej 30 shtator 2010,

² Prosecutor v. Anto Furundzija (Appeal Judgement), IT-95-17/1-A, International Criminal Tribunal for the former Yugoslavia (ICTY), para. 37.

1. Kushdo që, duke e ditur ose ka arsye për të ditur se pasuria e caktuar buron nga ndonjë formë e aktivitetit kriminal, pasuri kjo e cila në të vërtetë fitohet me veprë penale, apo kushdo që duke besuar se pasuria e caktuar fitohet nga ndonjë formë e aktivitetit kriminal.....

Tipar thelbësor i veprës penale kërkesa e dijenisë. Pyetja që shtrohet është: dijenia për çfarë? Duhet provuar se personi i përfshirë në transaksion kishte dijeni se paratë e kishin origjinën nga vepra penale apo aktiviteti kriminal.

Një fakt i tillë përkundër administrimit të numrit të madh të provave shkresore, dëgjimit të dëshmitarëve, të pandehurave, pas vlerësimit të deklarimeve të tyre ezaurues nuk është vërtetuar, e as nga faktet e tilla nuk ka derivuar përfundimi se të pandehurit ishin në dijeni apo mbi bazën e rrethanave objektive kishin arsye për të ditur.

Elementi i tjetër kërkon që transaksioni duhet të bëhet me qëllim: “për të mbuluar ose fshehur origjinën e pasurisë”.

Sipas Kolegjit në këtë çështjen penale nga provat në veçanti si dhe nga tërësia e provave dhe materialit provues të proceduar, nuk është arritur të vërtetohet se transaksionet e të akuzuarave në blerjen e pronave kishin për qëllim mbulimin apo fshehjen e origjinës së pasurisë së të akuzuarave në rastin T..., për rrjedhojë mungojnë dëshmitë se këto veprime ishin ndërmarrë për fshehjen e maskimin e pasurisë së të tyre, një rrethanë e tillë nuk mund të supozohet, nga faktet e çështjes rezultojnë se të njëjtit kishin blerë pronat për qëllimet tyre afariste dhe personale.

Po ashtu aktgjykimi i kundërshtuar nuk përmban as shkelje tjera të cilat kjo gjykatë konform dispozitave të nenit 394 të KPPK-së, i vëren çdo herë sipas detyrës zyrtare e të cilat do të kushtëzonin anulimin e tij.

Çështja e konfiskimit

Sa i përket konfiskimit të pasurisë prokuroria thekson se kishte paraqitur kërkesën për konfiskimin e pasurisë, bazën ligjore si dhe argumentet ligjore për konfiskimin e paluajtshmërive objekt i kësaj çështjeje ligjore. Lidhur me këtë gjykata ka marrë vendim për anulimin e pjesërishëm të Urdhëresës se lëshuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë PPP..., dhe se një vendim i tillë jo vetëm se është i kundërligjshëm por edhe i cenon parimet e shtetit ligjor, sepse është shenjë që tregon se grupe kriminale mund të tjetërsojnë pronën shtetërore përmes dokumenteve të falsifikuara dhe ta shesin atë pa frikë se e njëjta më vonë do të konfiskohet dhe do t'i kthehet shtetit.

Prandaj konfiskimi i të ardhurave nga krimi, i kërkuar nga prokuroria është i domosdoshëm dhe i detyrueshëm, aq më tepër kur e njëjta Gjykatë, nga provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor, kishte vërtetuar faktin se këto paluajtshmëri janë bartur në emër të personave të tretë përmes falsifikimit të dokumenteve. Përveç kësaj asetet të cilat aktualisht janë liruar nga sekuestrimi të përkohshëm vlerësohen nga ekspertët në vlerë prej miliona euro. Këto prona të vlefshme janë pa dyshim përfitime nga veprat penale përmes falsifikimit të dokumenteve dhe pastaj janë bartur në emër të të pandehurve.

Sipas vlerësimit të kësaj Gjykate këto pretendime janë të pabazuara, pasi që nga faktet e potencuara me lartë, nuk është vërtetuar se blerësit e këtyre paluatjshmërive këtu të akuzuarit të kenë pasur çfarëdo lidhje me subjektive me të akuzuarit në çështjen penale në rastin T...., për mes se cilave prova do të rezultonte dyshimi eventual i bazuar se këta të akuzuar kanë ditur, apo kanë mundur të ishin në dijeni, se vendimet gjyqësore, regjistri kadastral e fletët poseduese të akuzuarave në çështje penale T..., si (Sh.Ssi përfaqësues dhe në emër K.B, F.GE.G, Sh.M, E.U dhe I.S), ishin siguruar në mënyrë të kundërligjshme, ashtu që duke i ditur këto veprime, të njëjtit ti kanë ndihmuar të akuzuarve të lartcekur për kryerjen e aktiviteteve kriminale, apo se ka ekzistuar ndonjë marrëveshje paraprake për pastrimin e parave, si rrjedhojë e kësaj rezulton se paluajtshmërit e konfiskuara nuk e kanë burimin nga kryerja e veprës penale të pretenduar, si i tillë vendimi për lirim e tyre është i ligjshëm.

Përfundimi

Kolegji është i bindur se gjykata e shkallës së parë arriti në përfundimin e arsyeshëm se nga provat e zbatuara nuk është provuar përtej dyshimit të bazuar, se të akuzuarit e kanë kryer veprën penale për të cilën janë akuzuar, andaj me të drejtë janë liruar nga akuza për veprën për të cilën është akuzuar.

Nga arsyet e sipër cekura dhe në bazë të nenit 401 të KPPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS

APS.nr.21/23

Datë:05.07.2023

Bashkëpunëtorja profesionale,

Syzana Goxhuli

Kryetar i kolegjit,

Ferit Osmani

Anëtarët e kolegjit:

Bashkim Hyseni

Afërdita Bytyçi
